



**Analizë - Deklarimi i Pasurisë: Kontrolli dhe Vërtetësia e të Dhënave**

# Kriza e Depërtimit

---

**Publikuar nga:** Organizata për Demokraci, Anti-korrupsion dhe Dinjitet, Çohu!  
Rruga: 2 Korriku; Nr. 4/4 Prishtinë, Kosova  
Tel / +381 (0)38 2248 506  
[www.cohu.org](http://www.cohu.org)  
**Qershor, 2015**

---

*Kjo analizë është mundësuar me mbështetje të Civil Rights Defenders (CRD) dhe Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS)*



**Vërejtje:** Përmbajtja e kësaj analize është përgjegjësi e plotë e Organizatës Çohu!, dhe rrjedhimisht nuk reflekton qëndrimet e donatorëve të projektit.

**Autorë:** *Altin Ademi, Arton Demhasaj dhe Lorik Bajrami*

**Lekturoi:** *Besa Kalaja*

**Publikuar nga:** *Organizata për Demokraci, Antikorrupsion dhe Dinjitet, Çohu!*

*Rruga: 2 Korriku; Nr.4/4; Prishtinë, Kosova*

*Tel / +381 (0)38 2248 506*

[www.cohu.org](http://www.cohu.org)

---

# Përmbajtja:

|     |                                                                                                                                                                               |           |
|-----|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|
|     | <i>Metodologjia .....</i>                                                                                                                                                     | <i>5</i>  |
| 1.  | <i>Përmbledhje Ekzekutive .....</i>                                                                                                                                           | <i>8</i>  |
| 2.  | <i>Hyrje .....</i>                                                                                                                                                            | <i>13</i> |
| 3.  | <i>Deklarimi i pasurisë/aseteve: Qëllimi, Rezultatet e pritura dhe Sfidat e Implementimit në rastin e Kosovës .....</i>                                                       | <i>16</i> |
| 4.  | <i>Të Gjeturat Kryesore.....</i>                                                                                                                                              | <i>18</i> |
|     | <i>4.1 Trendi i Mosdeklarimit të Pasurisë .....</i>                                                                                                                           | <i>18</i> |
| 5.  | <i>Të gjeturat Empirike të Hulumtimit rreth Vërtetësisë së të Dhënave të Deklaruara .....</i>                                                                                 | <i>26</i> |
| 6.  | <i>Kundërvajtjet dhe Masat Ndëshkuese.....</i>                                                                                                                                | <i>32</i> |
|     | <i>6.1 Rasti i Deputetëve Nait Hasani dhe Duda Balje të Akuzuar për Vepër Penale sipas Nenit 437 të Kodit Penal për Mosdeklarim apo Deklarim të Rrejshëm të Pasurisë.....</i> | <i>38</i> |
| 7.  | <i>Procesi i Deklarimit të Pasurisë si Kontribues për Mosdeklarim.....</i>                                                                                                    | <i>41</i> |
| 8.  | <i>Vlefshmëria e të Dhënave: Segmentet Problematike .....</i>                                                                                                                 | <i>43</i> |
|     | <i>8.1 Mungesa e Qasjes në Banka dhe Institucione Financiare.....</i>                                                                                                         | <i>45</i> |
|     | <i>8.2 Mungesa e Standardeve për Konstatim të Vlerës së Deklaruar .....</i>                                                                                                   | <i>46</i> |
|     | <i>8.3 Mungesa e Standardizimit të Përmbajtjes së Emërtimeve dhe Nocioneve të Pasurisë.....</i>                                                                               | <i>46</i> |
|     | <i>8.4 Mungesa e Deklarimit të Detajuar të Aseteve mbi vlerën 3,000 Euro.....</i>                                                                                             | <i>46</i> |
|     | <i>8.5 Mosharmonizimi dhe Mos-sistemimi i Regjistrave për Deklarim të Pasurisë .....</i>                                                                                      | <i>47</i> |
|     | <i>8.6 Mungesa e të Dhënave rreth Origjinës së Pasurisë .....</i>                                                                                                             | <i>48</i> |
| 9.  | <i>Verifikimi i Origjinës së Pasurisë dhe Pasurisë Jashtë Vendit të Zyrtarëve të Lartë Publik .....</i>                                                                       | <i>49</i> |
|     | <i>9.1 Rasti i Behgjet Pacollit- Pamundësia e Verifikimit të Pasurisë Jashtë Vendit.....</i>                                                                                  | <i>50</i> |
|     | <i>9.2 Qasja “ortodokse” e Verifikimit: Rasti i Agim Bahtirit.....</i>                                                                                                        | <i>52</i> |
| 10. | <i>Përfundim .....</i>                                                                                                                                                        | <i>55</i> |
| 11. | <i>Rekomandimet Themelore .....</i>                                                                                                                                           | <i>57</i> |

## Shkurtesat:

---

**AKK-** Agjencia Kundër Korrupsionit

**DP-** Deklarimi i Pasurisë

**KPRK-** Kodi Penal i Republikës së Kosovës

**KPPRK-** Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës

**MD** - Ministria e Drejtësisë

**NIF-** Njësia e Inteligjencës Financiare

**PSH-** Prokuroria e Shtetit

**PTH-** Prokuroria Themelore

**PK-** Pikat e Kontaktit

**EU-** Bashkimi Evropian

## Lista e tabelave dhe grafikoneve

---

### Tabelat:

|   |                                                                                                                               |    |
|---|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| - | <b>Tabela 1.</b> Statistikat për mosdeklarim për vitet 2007-2009.....                                                         | 20 |
| - | <b>Tabela 2.</b> Rastet e iniciuara nga AKK për mosdeklarim dhe rastet e shqyrtuara nga gjykatat për vitin 2010 .....         | 20 |
| - | <b>Tabela 3.</b> Rastet e iniciuara nga AKK dhe shqyrtimet gjyqësore për mosdeklarim për vitin 2011 .....                     | 22 |
| - | <b>Tabela 4.</b> Rastet e iniciuara nga AKK për shkelje të nenit 437 të KPRK-së për vitin 2013 dhe 2014 .....                 | 33 |
| - | <b>Tabela 5.</b> Rastet e trajtuara nga prokuroritë publike për shkelje të nenit 437 të KPRK-së për vitin 2013 dhe 2014 ..... | 34 |
| - | <b>Tabela 6.</b> Shqyrtimet nga gjykatat për shkeljen e nenit 437 të KPRK-së për vitet 2013 dhe 2014 .....                    | 35 |

### Grafikonet:

|   |                                                                                                                           |    |
|---|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| - | <b>Grafikoni nr 1.</b> Të dhënat për mosdeklarim ndër vite.....                                                           | 19 |
| - | <b>Grafikoni nr 2.</b> Natyra e dënimeve të shqiptuara nga gjykatat. ....                                                 | 21 |
| - | <b>Grafikoni nr 3.</b> Natyra e dënimeve të shqiptuara nga gjykatat për vitin 2011 .....                                  | 22 |
| - | <b>Grafikoni nr 4.</b> Trendi i mosdeklaruesve në përqindje.....                                                          | 23 |
| - | <b>Grafikoni nr 5.</b> Trendi i mosdeklarimit të pasurisë 2007-2014.....                                                  | 24 |
| - | <b>Grafikoni nr 6.</b> Lista e zyrtarëve që nuk e kanë deklaruar pasurinë në afatin e rregullt vjetor për vitin 2015..... | 25 |
| - | <b>Grafikoni nr 7.</b> Të gjeturat e Çohu!.....                                                                           | 26 |
| - | <b>Grafikoni nr 8.</b> Rastet e mospërputhjes së deklarimit dhe mosdeklarimit të aseteve .....                            | 27 |

# Metodologjia

---

Kjo analizë është ndërtuar përmes Nivelit të Mesëm të Analizave,<sup>1</sup> një metodologji e kombinuar, duke pasur parasysh trendët e kërkimit shkencor në fushën e politikave kundër korrupsionit dhe interesit tonë për të interpretuar në mënyrë të pavarur dhe cilësore të dhënat mbi kontekstin e këtyre politikave në Kosovë.

## Qasja

Qasja për të ndërtuar një model vlerësimi mbi nivelin e implementimit të politikave kundër-korrupsionit në Kosovë dhe për të matur efektet e tyre është udhëhequr përmes perspektivës **interpretuese** dhe principeve të **Pragmatizmit të Zgjidhjes së Problemit**. Kjo qasje ka rrjedhur duke analizuar legjislacionin aktual dhe praktikën e implementimit përmes një modeli të kombinuar **kualitativ-kuantitativ**, ndërsa analizat janë bërë përmes logjikës së **deduksionit/ndërvlerësive**, duke synuar shpjegimin e rrjedhjes së proceseve nga ligji në praktikë në mënyrë që të kuptohen pretekstet, të metat apo paqartësitë në procesin e deklarimit të aseteve dhe politikave shtetërore për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit politik në këtë drejtim.

## Metodat

Duke pasur për bazë dizajnin hulumtues dhe analitik të këtij studimi, të dhënat empirike dhe vërtetimet e Çohu! janë përdorur për të ndërtuar aksiomat parimore përmes të cilave janë ndërtuar pyetjet dhe argumentet që kemi synuar t'i trajtojmë. Një metodë tjetër e përdorur është ajo **normative** (normative në kuptimin e ligjeve), përmes së cilës janë interpretuar segmente të caktuara të (mos)zbatimit të ligjeve të fushës në fjalë. Po ashtu, **analizat krahasuese** janë përdorur për të reflektuar modelet dhe parimet legjislative të kësaj fushe që zbatohen në vende të tjera.

Burimet e përdorura për të shtruar argumentet dhe analizuar të dhënat krahasuar me standardet ndërkombëtare përfshijnë:

- a) Legjislacionin primar dhe sekondar të fushës së anti-korrupsionit në Kosovë;
- b) Dokumente dhe analiza nga Banka Botërore, UN, OECD, EU etj;
- c) Raportet statistikore dhe dokumentet tjera relevante të përpunuara nga Agjencia Kundër Korrupsionit;
- d) Statistikat nga Prokurori i Shtetit dhe gjykatat;
- e) Të dhënat empirike të hulumtuara dhe përpunuara nga Çohu!; (Hulumtimi empirik i cili është ndërmarrë nga Çohu!, për nevoja specifike të këtij studimi është i bazuar në një

---

<sup>1</sup> Niveli i Mesëm i Analizave korrespondon me natyrën e studimit duke pasur parasysh se analizat në këtë nivel paraqesin një

mostër prej 199 regjistrave të pasurisë dhe ka synuar vërtetësinë e pasurisë së deklaruar duke përdorur metodën krahasuese me Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK), dhe me të dhënat e kadastrave komunale;

- f) Intervistat përmes telefonit me akterë të caktuar;
- g) Vizitat në institucionet relevante.

### Rastet e Studimit

Në kuadër të analizës krahasuese, ne kemi shqyrtuar praktikën aktuale të deklarimit të aseteve në disa vende në rajon dhe më gjerë siç janë Shqipëria, Mali i Zi, Serbia, Maqedonia, Kroacia, Sllovenia, Estonia, Lituania etj, përfshirë edhe segmente të deklarimit të aseteve parë nga perspektiva globale që kanë të bëjnë me konditat ligjore, qasjet metodologjike dhe instrumentet e verifikimit të pasurisë së deklaruar.

Për më tepër, ne kemi përzgjedhur disa raste specifike të studimit për të adresuar disa çështje dhe probleme me procesin e deklarimit të aseteve në Kosovë, veçanërisht ato që dëshmojnë për zbrazëtitat në kuadrin ligjor, mungesat e theksuara të zbatimit të ligjeve dhe për paqartësi në segmente akute të këtij procesi.

Duke pasuar këtë logjikë, rastet e përzgjedhura për të argumentuar këto probleme të sistemit aktual të deklarimit të aseteve janë si vijon:

- a) Rasti i kryetarit të Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, i trajtuar nga AKK-ja për konflikt të mundshëm interesi dhe i cili sipas pikëpamjes sonë e dëshmon qasjen shumë të ngushtë që e përdorë AKK për të verifikuar lidhjet biznesore të subjekteve të ndryshme ndërmjet vete;
- b) Rasti i ish zv. Kryeministrit të Kosovës, Behgjet Pacolli, i trajtuar sipas pikëpamjes sonë si një rast që dëshmon pamundësinë e AKK-së për të verifikuar pasurinë jashtë vendit të zyrtarëve të lartë publik dhe si një rast që dëshmon për shkelje të legjislacionit vendor;
- c) Rastet e deputetëve të Kuvendit të Kosovës, Nait Hasani dhe Dude Balje, të cilët paraqesin hedhjen poshtë nga gjykatat të akuzave të AKK-së për shkelje të dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Kosovës përkitazi nenin 437 për deklarim të rrejtshëm të pasurisë, përmes të cilave trajtohet aspekti i metodologjisë së vlerësimit se çka AKK konsideron deklarim të rrejtshëm të pasurisë;
- d) Raste të studimit rreth mos-harmonizimit dhe mos-sistemimit (të meta materiale dhe teknike) të regjistrave të pasurisë përmes të cilave dëshmohet pamundësia e shoqërisë civile për të ushtruar kontroll alternativ mbi saktësinë e të dhënave për pasurinë e deklaruar si dhe pamundësinë për të ofruar analiza aritmetike mbi relacionin e të hyrave të subjekteve deklaruese dhe pasurive që ata/ato i posedojnë. Kjo pjesë po ashtu

dëshmon për të meta në mekanizimin e kontrollit paraprak të regjistrave të pasurisë që bëhet nga Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK).

Përveç rasteve të sipërpërmendura, të dhënat empirike nga Çohu! kanë ofruar aspekte të shkeljeve të ligjeve kundër korrupsionit nga zyrtarët e lartë publik sa i përket mosdeklarimit, deklarimit të rrejshëm, fshehjes së informatave etj, të cilat janë trajtuar në një kapitull të kësaj analize.

Ideja qendrore prapa këtyre rasteve të studimit ka për qëllim që të adresojë problemet me metodologjinë e punës së AKK-së, dhe duhet parë si një kontribut në rrjedhën e debatit mbi atë se çfarë duhet ndryshuar në mënyrë që të sigurohet një funksionim me integritet, një mandat i qartë dhe një metodologji e suksesshme kundër korrupsionit politik në Kosovë, përmes sistemit adekuat dhe efektiv të deklarimit të pasurisë dhe mekanizmave të kontrollit të saj.



# 1. Përmbledhje Ekzekutive

---

Republika e Kosovës, është duke u përpjekur për të ndërtuar kapacitete institucionale në mënyrë që të sigurojë një shoqëri të lirë dhe demokratike, institucione publike të përgjegjshme dhe sundim të rendit dhe ligjit.

Megjithatë, këto përpjekje shpesh herë nuk janë të lehta dhe kundër-balanohen me sfida të ndryshme, duke filluar që nga tradita post-socialiste e logjikës institucionale në njërën anë, si dhe një dominim i një kulture politike parokiale që nuk korrespondon përgjithësisht me standardet bashkëkohore të rendit demokratik, në anën tjetër. Pasojat e këtyre sfidave shfaqen në shumë dimensione, përfshirë këtu edhe në mungesën e besimit në institucionet publike. Ky mosbesim është krijuar përmes përshtypjeve të ekzistimit të fenomeneve siç është korrupsioni dhe pasurimi i paligjshëm i zyrtarëve publik, dukuri këto të cilat kanë prekur sektorin publik të Republikës së Kosovës.

Kjo analizë adreson problematikën e mekanizimit të kontrollit të pasurive të zyrtarëve të lartë publik dhe instrumenteve që kanë për qëllim parandalimin e keqpërdorimit të këtij mekanizmi. Synimi kryesor është që të analizohen trendët dhe praktikët që kanë për qëllim ta mbikëqyrin dhe ta bëjnë sa më transparente pasurinë e zyrtarëve të lartë publik, në mënyrë që të përcjellin legjitimitetin e pasurisë së tyre dhe që të parandalojnë konfliktin(et) e mundshme të interesit. Shembujt dhe logjika e trajtimit të problematikës së deklaramit të pasurisë të pasqyruar në këtë analizë janë ndërtuar përmes tri aspekteve themelore:

- a) Legjislacioni aktual që rregullon fushën e deklaramit të pasurisë në Republikën e Kosovës;
- b) Metodologjia e AKK-së përkitazi me çështjen se çfarë/cilat instrumente i përdorë ky organ për të vërtetuar saktësinë e të dhënave të deklaruara (pasurisë); dhe
- c) Të dhënat empirike të Çohu! që pasqyrojnë segmente të realitetit ekzistues në këtë agjendë;

Rezultatet, përfundimet dhe rekomandimet që reflektohen në këtë analizë, nuk kanë qëllim primar të kritikojnë punën apo mospunën e akterëve të përfshirë në agjendën e luftimit të korrupsionit, por që të kontribuojnë në shtrimin e shumë segmenteve që janë bërë dhe vazhdojnë të jenë shkas për perceptimin e krijuar të prezencës së korrupsionit politik në Kosovë.

Në kuadër të analizës janë shtruar argumente, janë dhënë shembuj konkret dhe janë analizuar raste specifike që adresojnë problematikën e procesit të deklaramit të pasurisë, me theks të veçantë në instrumentet që synojnë të realizojnë këtë proces. Disa nga të gjeturat dhe

përfundimet kryesore të cilat gjinden në brendësi të tekstit në mënyrë më të hollësishme, janë dhënë shkurtimisht si vijon:

### **Të gjeturat nga aspekti ligjor:**

- Legjislacioni aktual ka dështuar që të ofrojë një strukturë ligjore të përshtatshme që adreson nevojat e realitetit socio-kulturor dhe socio-politik në luftën kundër korrupsionit, veçmas korrupsionit politik;
- Ka mospërputhje të disa aspekteve themelore në mes të ligjeve bazë kundër korrupsionit dhe ligjeve tjera relevante siç ka edhe konflikt në disa aspekte me Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës;
- Rishqyrtimi i ligjeve bazike kundër korrupsionit dhe veçanërisht Ligji për Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe Ligji për Deklarim të Pasurisë, është e një nevojë urgjente. Po ashtu, një harmonizim i ligjeve kundër korrupsionit në mes vete si dhe harmonizimi i tyre me Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës është i domosdoshëm;

### **Të gjeturat nga aspekti i procesit të deklarimit të pasurisë:**

- Procesi i Deklarimit të Pasurisë, parë nga aspekti strukturor realizohet brenda kushteve të parapara me ligj, edhe pse në disa raste me të meta të theksuara. Mirëpo, ka shumë të meta për nga aspekti përmbajtësor siç është problemi me vlefshmërinë/saktësinë e të dhënave të deklaruara, si pasojë e mungesës së instrumenteve dhe kompetencave verifikuese nga ana e AKK-së;
- Mungesa e qasjes në banka dhe institucione financiare e minon punën e AKK-së pasi që kjo e fundit nuk e ka në dispozicion një nga instrumentet më të rëndësishme të verifikimit të të dhënave të deklaruara të zyrtarëve të lartë publik;
- Një nga aspektet problematike është edhe pamundësia e AKK-së për të pasur çfarëdo qasje në pasuritë që zyrtarët e lartë publik mund të kenë jashtë vendit;
- Po ashtu një aspekt problematik është edhe pamundësia e AKK-së për të vërtetuar origjinën e pasurisë;
- Mungesa e standardeve për konstatim të vlerës së deklaruar paraqet po ashtu një problem pasi që AKK-ja nuk ka në dispozicion asnjë mekanizëm për të vlerësuar përmbajtjen apo vlerën reale të pasurisë së deklaruar nga ana e zyrtarëve të lartë publik;
- Mungesa e standardizimit të përmbajtjes së emërtimeve dhe nocioneve të pasurisë paraqet po ashtu një problem në procesin e deklarimit të pasurisë dhe veçanërisht në përcaktimin e vlerës së pasurisë;

- Ka një mungesë të theksuar të harmonizimit të regjistrave të pasurisë në aspektin material dhe teknik, gjë që paraqet pengesë serioze për monitorim të pasurive të deklaruara si nga AKK-ja, por edhe nga palët e treta;
- Me gjithë progresin legjislativ në aspektin e masave shtrënguese dhe dënuese rreth deklarimit të rrejshëm dhe refuzimit të deklarimit të pasurisë, të dhënat tregojnë se këto masa nuk janë duke prodhuar rezultate domethënëse;
- Trendi i mosdeklarimit të pasurisë ka shënuar rritje nga viti 2007 deri në vitin 2012, krahas rritjes së numrit të zyrtarëve të obliguar ta deklarojnë pasurinë. Në këto vite, mos-deklarimi i pasurisë ka rezultuar me shkelje administrative (2007-2010), dhe me kundërvajtje (2010-2012).
- Në vitin 2013 ka hyrë në fuqi Kodi Penal i Republikës së Kosovës, i cili në nenin 437 ka paraparë si vepër penale edhe mosdeklarimin apo deklarimin e rrejshëm të pasurisë, i cili ndryshim ka ndikuar pjesërisht në reduktimin e numrit të zyrtarëve që nuk e deklarojnë pasurinë në afatin e rregullt vjetor. Në kategorinë e deklarimit vjetor, numri i zyrtarëve që nuk e kanë deklaruar pasurinë ka shënuar ulje drastike në vitin 2013 dhe në vitin 2014, krahasur me vitet paraprake (2007-2012), përderisa në vitin 2015, numri i zyrtarëve që nuk e kanë deklaruar pasurinë ka shënuar rritje domethënëse krahasuar me dy vitet paraprake (2013/14);
- Një numër i konsiderueshëm i mosdeklaruesve të pasurisë në vitin 2015, kanë rastisur të marrin detyrën para afatit të rregullt të deklarimit të pasurisë dhe si të tillë deklarojnë pasurinë për herë të parë. Kjo lenë të kuptohet se të njëjtit nuk kanë njohuritë e duhura për procesin e deklarimit, njëherit kjo mund të ndodhë edhe si pasojë e (mos)funksionimit të mirëfilltë të pikave të kontaktit apo mosinformimit adekuat të këtyre mosdeklaruesve rreth obligimeve dhe pasojave ligjore në këtë drejtim;
- Në numrin e lartë të mosdeklaruesve, por veçanërisht të atyre që nuk e deklarojnë saktë pasurinë ndër vite mund të kenë ndikuar edhe pamundësia e AKK-së për të verifikuar saktësinë e të dhënave dhe për të siguruar kontrollin e origjinës së tyre;

### **Të gjeturat në kontekstin e rasteve kundër nenit 437 (mos deklarim dhe deklarim i rrejshëm i pasurisë) dhe natyrës së dënimeve:**

- Për vitet 2007-2010, legjislacioni në fuqi nuk ka paraparë shkallë të dënimeve penale pasi që Kodi Penal, nuk e parashihte mosdeklarimin apo deklarimin e rrejshëm si vepër penale;
- Ligji i vitit 2010, dhe më pas ligji aktual kanë prezantuar dënimet me gjobë vlera e të cilave është rritur dy herë, por këto masa nuk kanë dhënë asnjë rezultat pasi që zakonisht në shkallën e dytë të shqyrtimit gjyqësor, përkatësisht në Gjykatën për Kundërvajtje, si dhe shkallën e parë dhe të dytë të apelit, këto dënime janë reduktuar

dhe janë bërë pothuajse të papërfillshme. Si të tilla, këto dënime nuk janë konsideruar si pengesa serioze për të mosdeklaruar pasurinë nga ana e zyrtarëve të lartë publik;

- Pas hyrjes në fuqi të Kodit Penal të Kosovës, përkitazi me nenin 437 që parasheh veprën penale për mosdeklarim apo deklarim të rrejshëm të pasurisë, për vitet 2013-2014, AKK-ja ka iniciuar gjithsej 163 raste, ndërsa prokuroritë kanë ngritur 95 aktakuza. Në mesin e këtyre aktakuzave ka edhe të tilla që parashohin dhënien e urdhrit ndëshkimor, që paraqet një shkelje pasi që neni 437 i Kodit Penal, nuk parasheh dënime të tjera alternative përveç se “me gjobë dhe me burgim”;
- Gjatë viteve 2013-2014, përkitazi me shkeljen e nenit 437 për mosdeklarim apo deklarim të rrejshëm të pasurisë, gjykatat kanë pasur gjithsej 193 lëndë në punë, prej të cilave kanë shqyrtuar vetëm 30 apo 15% të tyre, që flet për një trend tejet të ultë të shqyrtimit të lëndëve kundër korrupsionit dhe që mund të përbëjë një stimulim për kryesit e veprës penale të mosdeklarimit apo deklarimit të rrejshëm të pasurisë;
- Nga gjithsej 30 vendimet e marra nga gjykatat, është shqiptuar vetëm një dënim me burg, ndërsa 10 vendime janë dhënë me aktgjykim lirues, refuzues apo janë zgjedhur në mënyrë tjetër. Përderisa, 7 raste janë parashkruar në afat absolut, si dhe 12 vendime të gjykatave kanë karakter alternativ të dënimit gjë që potencialisht bien ndesh me Kodin Penal, përkatësisht nenin 437 i cili parasheh vetëm dënime me *gjobë dhe me burgim*, duke përjashtuar format tjera alternative të dënimit;
- Një aspekt problematik dhe që ka ndikuar në shkallën e ulët të dënimeve (dënimet alternative) është edhe mospërpunimi i duhur i lëndëve nga ana e AKK-së, konkretisht në atë se çka ky mekanizëm ka konsideruar si deklarim i rrejshëm i pasurisë.

### Të gjeturat nga hulumtimi empirik i Çohu!-të:

- Nga numri prej 199 zyrtarëve që kanë qenë subjekt i hulumtimit nga ana e Çohu!-t, në 8 raste ka mospërputhje të deklarimit të pronave dhe pasurisë së patundshme krahasuar në regjistrin e pasurisë së AKK-së, me të dhënat e siguruara nga zyrat kadastrale nëpër komuna;
- Në 3 raste është vërejtur mosdeklarimi nga ana e zyrtarëve të lartë publik, të pronësisë që ata kanë mbi biznese të caktuara, që paraqet shkelje të drejtpërdrejtë sipas nenit 437 të Kodit Penal;
- Në 4 raste është gjetur mosdeklarimi i bizneseve në periudhën e paraparë më ligj (31 Mars), ku pavarësisht arsyetimeve të bëra nga zyrtarët përkatës për mungesën e aktivitetit të këtyre bizneseve apo mos-menaxhimit të tyre nga ana e zyrtarëve, ligji në mënyrë specifike obligon deklarimin e tyre përderisa të njëjtat figurojnë të regjistruara në emër të zyrtarëve të lartë publik në Agjencionin për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë - ARBK;



- Në 4 raste është vërejtur shpërputhje e formës së deklaramit të pasurisë, ku zyrtarët kanë deklaruar të hyra nga bizneset por nuk i kanë paraqitur ato si biznese në pronësi të tyre, apo si posedues të aksioneve apo të ndonjë forme tjetër të lidhjes me to;

### **Të gjeturat në raport me mandatin e AKK-së:**

- AKK-ja nuk ka mandat të mirëfilltë dhe të fuqishëm për hetimin e plotë të pasurisë që zyrtarët e lartë publik e deklarojnë, pasi që nuk mund të përdorë një nga instrumentet themelore për verifikim, qasjen në llogaritë bankare;
- AKK-ja nuk ka bërë asnjëherë ndonjë analizë që ka për bazë llogaritjen aritmetike në mes të hyrave dhe pasurive të deklaruara, mbi bazën e së cilave do të mund të konstatonte përputhshmërinë në mes të standardit të jetës së zyrtarëve të caktuar duke i krahasuar me të hyrat vjetore;
- AKK-ja nuk ka qasje për të verifikuar dhe kontrolluar pasurinë jashtë vendit të zyrtarëve të lartë publik;
- AKK-ja nuk ka në dispozicion asnjë mekanizëm për verifikimin e origjinës së pasurisë së zyrtarëve të lartë publik;
- Tendenca e AKK-së për t'u profilizuar përherë e më shumë me kompetenca ekzekutive sipas qasjes së deritanishme nuk përcillet me një vizion real për mandatin e saj. Qasja përmes së cilës kërkohet të aludohet në kompetenca të përfituara përmes nënshkrimit të "Memorandumeve të Mirëkuptimit", të cilat bazohen në vullnetin ndër-institucional është e pamjaftueshme për një mandat të mirëfilltë dhe kuptimplotë;
- Është e një nevojë urgjente që të rishikohet ligji për Agjencinë Kundër Korrupsionit, krahas ligjeve tjera bazike kundër korrupsionit në mënyrë që të sqarohet, plotësohet dhe forcohet në përpikëri mandati i saj si dhe të sqarohet në përpikëri metodologjia e punës dhe instrumentet që AKK-ja ka në dispozicion për të kryer hetime administrative dhe hetime përmbajtjesore rreth deklaramit të pasurisë.

## 2. Hyrje

Ekziston një përshtypje e përgjithshme që del nga hulumtimet e opinionit publik, tek shoqëria civile dhe tek qytetarët se korrupsioni në Kosovë, e veçmas ai politik, është i kudondodhur<sup>2</sup> dhe se i njëjti po shkakton hapa mbrapa në perspektivën e Kosovës drejt integriteteve evropiane dhe në vetë mirëqenien e shoqërisë. Përshtypje të tilla janë të pranishme në shumë sfera të kontekstit social, politik dhe ekonomik.

Kjo analizë është ndërtuar mbi perspektivën e analizimit dhe rishikimit kritik të implementimit të legjislacionit, praktikës dhe rezultateve në agjendën kundër korrupsionit në Republikën e Kosovës, me theks të veçantë në procesin e deklarimit të pasurisë dhe mekanizmave të kontrollit të kësaj pasurie.

Fryma e profilizimit të sistemit kundër korrupsionit dhe ngritjes së efektivitetit të tij është përcjellur edhe në legjislacionin themelor aktual,<sup>3</sup> në përpjekjet institucionale,<sup>4</sup> të udhëhequra edhe nga rekomandimet e Bashkimit Evropian,<sup>5</sup> dhe ka ndikuar në krijimin e një "atmosfera" të përshtatshme për adresimin e duhur të agjendës kundër korrupsionit. Në këtë kuadër, ne e gjejmë tejet të rëndësishme matjen e masave të ndërmarra dhe efekteve ditore të këtyre masave në mënyrë që të krijohet një sistem i të kuptuarit të së paku tri çështjeve:

- a) Nëse legjislacioni aktual dhe trupat implementues të tij<sup>6</sup> kanë arritur të ndërtojnë në mënyrë të suksesshme instrumentet dhe metodat e duhura jo vetëm për të luftuar korrupsionin por edhe për ta parandaluar atë dhe për të edukuar institucionet publike rreth forcimit të integritetit të tyre;

<sup>2</sup> Transparency International (2013) *Barometri Global i Korrupsionit*, fq. 33;

<sup>3</sup> Me ligje bazike ne kemi në mëndje: Ligjin për Deklarimin e Pasurisë, Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit dhe Ligjin për Agjencinë Kundër Korrupsionit;

<sup>4</sup> Në kuptim të përpjekjeve institucionale, ne i referohemi Këshillit Kombëtar Kundër Korrupsionit, i themeluar në Shkurt të vitit 2012 nga Presidentja e Kosovës, por gjithashtu Task Forcës Kundër Korrupsionit nën Zyrën e Prokurorisë Speciale;

<sup>5</sup> a) Komisioni Evropian (2014) *Raporti i Progresit për Kosovën*, fq. 16;

[http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2014/20141008-kosovo-progress-report\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20141008-kosovo-progress-report_en.pdf)

b) EU – Kosovo Stabilisation Association Process Dialogue (SAPD), Conclusions, 28-30, January 2014.

[http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/eu\\_kosovo/20140131\\_final\\_conclusions\\_-\\_sapd\\_committee\\_on\\_ifs.pdf](http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/eu_kosovo/20140131_final_conclusions_-_sapd_committee_on_ifs.pdf)

c) EU – Kosovo Stabilisation Association Process Dialogue (SAPD), Conclusions, 24 June, 2014.

Second report on progress by Kosovo\* in fulfilling the requirements of the visa liberalisation roadmap, 24 Jult, 2014.

[http://ec.europa.eu/dgs/home-affairs/what-is-new/news/news/docs/accompanying\\_staff\\_working\\_document\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/dgs/home-affairs/what-is-new/news/news/docs/accompanying_staff_working_document_en.pdf)

d) Projekti kundër Krimet Ekonomik në Kosovë1 (PKEK), Raport vlerësimi për përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare në fushën e Luftës Kundër Korrupsionit (KK), Cikli 1, 10, Qershor, 2013.

[http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/press\\_corner/2590\\_peck\\_ac\\_final\\_dar\\_17\\_06\\_2013.pdf](http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/press_corner/2590_peck_ac_final_dar_17_06_2013.pdf)

e) Raport vlerësimi mbi përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare në fushën e luftës kundër korrupsionit (LKK), Prill, 2015.

<http://www.coe.int/t/DGHL/cooperation/economiccrime/corruption/Projects/PECK-Kos/PUBLICATIONS/AC%20ALB%20WEB.pdf>

<sup>6</sup> Këtu i referohemi ligjeve kundër korrupsionit të lartpërmendura si dhe institucioneve që zbatojnë ato siç janë Agjencia Kundër Korrupsionit, prokuroritë dhe gjykatat.

- b) Nëse procesi i deklarimit të pasurisë ka vendosur një standard të mirëfilltë të deklarimit të tërësisë së pasurisë së zyrtarëve dhe interesave të tyre si dhe vërtetësisë së të dhënave, duke parandaluar kështu konfliktin(et) e interesit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare; si dhe
- c) Nëse Agjencia Kundër Korrupsionit (më tutje në tekst: AKK) ka një mandat të fortë dhe të qartë në agjendën kundër korrupsionit dhe cilat do të ishin alternativat për fuqizimin e mëtejshëm të këtij mandati.

Rëndësia e adresimit të mekanizmave dhe praktikës së implementimit të ligjeve kundër korrupsionit dhe analiza e rezultateve të arritura sipas pikëpamjes sonë është esenciale në mënyrë që të kuptohet jo vetëm trendi i rënie-ngritjes por edhe vetë natyra e korrupsionit. Nga kjo perspektivë, do të mund të adresoheshin edhe aspektet e modelit të deklarimit të pasurisë (më tutje në tekst: DP), konkretisht çfarë funksionon dhe çfarë do të duhej të rishikohej në një proces të ardhshëm, në mënyrë që i tërë modeli të korrespondojë me nevojat reale në luftën kundër korrupsionit. Analiza po ashtu trajton ndryshimet e bëra në Kodin Penal të Kosovës, dhe efektet që këto ndryshime kanë pasur në aspektin e DP-së.

Krahas trajtimit të çështjeve që kanë të bëjnë me metodologjinë e sistemit të DP-së në Kosovë dhe me aspektet legislative, kjo analizë adreson edhe disa çështje për debat të cilat janë shumë të rëndësishme dhe kanë zënë vend në rrafshin global, ndonëse ende nuk shtrohen në Kosovë, në mes të cilave edhe:

- Nevoja për të matur me saktësi nivelin e korrupsionit politik, pikat ku ai është i pranishëm si dhe format e manifestimit në mënyrë që ai të luftohet me sukses;
- Nevoja për të rishikuar legjislacionin në fuqi dhe për të harmonizuar dispozitat ligjore bazuar në kriterin e sqarimit të plotë të aspekteve që janë të detyrueshme dhe atyre që janë subjekt i vullnetit të institucioneve, sidomos në rastin e Kosovës ku siç do të shihet më tutje në tekst ka pasur raste të iniciativave pa bazë ligjore dhe në anën tjetër iniciativave me bazë ligjore por me mungesë vullneti ndër-institucional; dhe
- Nevoja e të bërit të njohur metodologjinë e punës së AKK-së, pasi që paqartësitë mbi rolin dhe mandatin e saj dhe instrumenteve që ajo ka në dispozicion për të verifikuar pasurinë apo për të mbikëqyrur të njëjtën kanë çuar në dështim të disa rasteve gjatë proceseve gjyqësore.

Pika kryesore që shtjellon kjo analizë është e ndarë në tre rrafshe: **1) Rishikimi kritik i procesit të deklarimit të pasurisë** ku përfshihen aspektet legislative, mandati i AKK-së, etj; **2) Saktësia e të dhënave të deklaruara të pasurisë/aseteve**, ku përfshihen analiza e instrumenteve që përdorë AKK-ja për të verifikuar saktësinë e tyre; dhe **3) Kontrolli i origjinës së pasurisë**, ku përfshihen segmentet problematike për verifikimin e prejardhjes së pasurisë të zyrtarëve të

lartë publik brenda dhe jashtë vendit. Këto segmente do të trajtohen mbi prizmin e situatës reale të luftës kundër korrupsionit bazuar në statistikën e rasteve të iniciuara nga AKK-ja, rasteve të shqyrtuara nga prokuroritë dhe nga gjykatat, por edhe nga hulumtimi vetanak i Çohu!-të, i cili ka për bazë verifikimin alternativ të pasurisë së deklaruar nga 199 zyrtarë të lartë publik.

Duhet përmendur që puna për të mbledhur informacionet e duhura dhe për të studiuar në mënyrë të mirëfilltë metodologjinë e punës së AKK-së nuk ka qenë gjithmonë e lehtë, për shkak të mungesës së bashkëpunimit nga ana e Agjencisë, për të dhënë informata rreth mënyrës së tyre të punës dhe posaçërisht rreth mënyrës se si ky mekanizëm vlerëson apsektin e deklarimit të rrejshëm të pasurisë.

Megjithatë, përkushtimi ynë si Çohu!, ka bërë të mundur që paralelisht me të kuptuarit e rëndësisë së adresimit të çështjeve që trajton kjo analizë si pjesë e kontributit të shoqërisë civile në ndërtimin e institucioneve publike me integritet, të arrijë të shtrojë për debat më të gjerë aspekte të procesit të deklarimit të pasurisë, duke synuar kështu stimulimin e këtij debati deri në formën e rishikimit të aspekteve në fjalë.



### 3. Deklarimi i pasurisë/aseteve: Qëllimi, Rezultatet e pritura dhe Sfidat e implementimit në rastin e Kosovës

---

Korrupsioni përgjithësisht paraqet një temë të gjerë. Si i tillë, shpesh është i mbështjellur me perceptimet e të qenurit prezent çdokund, kryesisht në adresë të pasurimit të zyrtarëve të lartë publik përmes shpërdorimit të pozitës dhe parasë publike. Për shkak të natyrës së gjerë të tij dhe perceptimeve që e shoqërojnë atë, sipas pikëpamjes tonë dhe qasjeve të pranuar ndërkombëtarisht, është e rëndësishme që megjithatë, statistikave të korrupsionit të kuptohen vetëm në shkallën se sa prej rasteve të korrupsionit arrijnë në vëmendjen e institucioneve dhe se jashtë këtij kriteri, ato nuk nënkuptojnë qëllimin, format e manifestimit dhe depërtimit të korrupsionit në institucione në përgjithësi në një vend të caktuar.<sup>7</sup>

Për këtë arsye, ne konsiderojmë se puna dhe përforma e institucioneve që kanë për synim parandalimin dhe luftimin e korrupsionit politik duhet të jetë objektivi kryesor i analizave të kësaj fushe, duke u drejtuar në vlerësimin e implementimit të legjislacionit që e adreson këtë problematikë.

Përpjekjet institucionale dhe interesi për të ndërtuar mekanizma të duhur për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit politik është duke u rritur në rrafshin global edhe për shkak të ndikimit që kanë qytetarët, shoqëria civile dhe akterë të tjerë avokues për sundim të rendit dhe ligjit. Megjithatë sfera publike është e pranishme në shumë segmente socio-ekonomike, e politike të jetës sonë të përditshme, kërkesat dhe principet e politikave që kanë për synim ndërtimin e një sektori publik të shëndetshëm udhëhiqen dhe kanë për qëllim të sigurojnë:<sup>8</sup> transparencë, parandalim të konfliktit të interesit dhe monitorim të pasurisë së zyrtarëve të lartë publik. Koncepti i transparencës, konfliktit të interesit dhe deklarimit të pasurisë me këtë rast shkojnë më larg sesa thjeshtë statistikave, qeverisja e mirë dhe besimi në institucione. Në fakt, këto koncepte në agjendën kundër korrupsionit përfaqësojnë një tërësi të së paku tre aspekteve konkrete:

- 1) Identifikimit të korrupsionit dhe caqeve të mundshme të tij;
- 2) Parandalimit të korrupsionit dhe edukimit të institucioneve publike mbi integritetin e tyre;

---

<sup>7</sup> Joutsen, M. & Keranen, J. (2009), *Corruption and the prevention of corruption in Finland*, Ministry of Justice, fq 3;

<sup>8</sup> OECD (2011), *Asset Declarations for Public Officials: A tool to prevent corruption*, OECD Publishing, fq. 12;  
<http://www.oecd.org/corruption/anti-bribery/47489446.pdf>

- 3) Zhdukjes së mundësive për korrupsion politik përmes sigurimit të kornizës ligjore adekuate dhe efektive, si dhe garantimit të zbatimit të këtij legjislacioni përmes mekanizmave institucional efektiv dhe të pavarur si dhe instrumentit të sanksioneve që sigurojnë rezultate konkrete.

Meqenëse Kosova është përshkruar shpesh si një vend me potencial të lartë të korrupsionit politik, bazuar në shumë raporte dhe analiza statistikore, figuron që perceptimet për institucionet më të korruptuara përfshijnë gjyqësorin (85% e respondentëve kanë perceptime se gjyqësori është jashtëzakonisht i korruptuar) dhe partitë politike (75% e respondentëve i shohin partitë politike si jashtëzakonisht të korruptuara).<sup>9</sup> Përderisa këto dy institucione përfshijnë aspekte të rëndësishme të sferës publike, fokusi ynë primar në këtë analizë është që të analizohet fushëveprimi dhe praktika në lidhje me instrumentet e deklarimit të pasurisë dhe veçanërisht origjina e pasurisë dhe saktësia e të dhënave të deklaruara, si një argument për të parë modelin e kontrollit dhe monitorimit të pasurisë së zyrtarëve të lartë publik.

---

<sup>9</sup> Transparency International - Global Corruption Barometer - 2013.  
<http://www.transparency.org/gcb2013/country/?country=kosovo>

## 4. Të gjeturat kryesore

Procesi i deklarimit të pasurisë në Kosovë ka filluar nga viti 2007, në kohën kur po vendoseshin bazat e para të një tradite me Konventën e Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit<sup>10</sup> si dhe instrumenteve të tjera ndërkombëtare. Në fillim, ky proces, ndonëse kërkohej me Ligjin Kundër Korrupsionit, paraqiste kryesisht një proces administrativ. Agjencia Kundër Korrupsionit, si organ që zbatonte procesin e DP-së, ishte ende në proces të funksionalizimit të plotë dhe të ndërtimit të fizionomisë së saj. Pas plot shtatë vitesh, kanë ndodhur ndryshime të rëndësishme që lidhen me procesin e DP-së, të cilat do t'i reflektojmë më tutje, ndonëse një numër i madh problemesh ka mbetur i njëjtë, e të cilat paraqesin aspekte të rëndësishme për shqyrtim.

### 4.1 Trendi i mosdeklarimit të pasurisë:

Në grafikonin në vijim janë paraqitur të dhënat statistikore të mosdeklarimit të pasurisë nga ana e zyrtarëve të lartë publik, sipas katër kategorive ligjore të parapara, për vitet 2007-2014. Nga kjo paraqitje grafike mund të kuptojmë se trendi i mosdeklarimit ka qenë përgjithësisht i lartë ndër vite, deri me futjen e masës së veprës penale për mosdeklarim sipas nenit 437 të Kodit Penal të Kosovës më 2013.<sup>11</sup>

Më konkretisht, në vitin 2007, nga 732 zyrtarë të lartë publik të paraparë për të deklaruar pasurinë, **14** prej tyre kanë dështuar ta bëjnë këtë.<sup>12</sup> Për këtë vit, AKK nuk ka sqaruar kategoritë përkatëse të parapara me ligj për deklarimin e pasurisë se në cilën kategori të deklarimit<sup>13</sup> hyjnë këto 14 raste. Në këtë periudhë AKK-ja ka iniciuar rastet për mosdeklarim të pasurisë sipas së cilave, masat e propozuara ishin:

- a) Reduktim i pagës për 1/5; dhe
- b) Propozim për shkarkim nga detyra zyrtare;

Në vitin 2008, numri i zyrtarëve të lartë publik që nuk e kanë deklaruar pasurinë ka qenë po ashtu **14**, nga numri i përgjithshëm prej 747,<sup>14</sup> ndaj të cilëve AKK-ja ka propozuar masat e njëjta administrative si në vitin paraprak.

<sup>10</sup> United Nations Office on Drugs and Crime, UNODC (2004); United Nations Convention Against Corruption: [http://www.unodc.org/documents/treaties/UNCAC/Publications/Convention/08-50026\\_E.pdf](http://www.unodc.org/documents/treaties/UNCAC/Publications/Convention/08-50026_E.pdf)

<sup>11</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës (2012): Kodi Penal i Republikës së Kosovës: Neni 437 <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2834>

<sup>12</sup> AKK (2008) Raporti Vjetor 2007; <http://www.ACA-ks.org/repository/docs/Raporti%20final%20-%2026%20Shkurt%202008-f.pdf>;


<sup>13</sup> Sipas Ligjit për Deklarimin e Pasurisë, Neni 6, parasheh katër lloje të deklarimit: "Deklarimin me marrjen e detyrës, deklarimin e rregullt vjetor, deklarimin me kërkesë të AKK-së, si dhe deklarimin pas mbarimit apo shkarkimit nga funksioni"

<sup>14</sup> AKK (2009) Raporti Vjetor 2008; [http://www.ACA-ks.org/repository/docs/Raporti\\_vjetor\\_2008.pdf](http://www.ACA-ks.org/repository/docs/Raporti_vjetor_2008.pdf)



Në vitin 2009, nga numri prej 800 zyrtarësh të lartë të paraparë për deklarim, **16** prej tyre nuk e kanë deklaruar pasurinë.<sup>15</sup> Për këto tri vite, AKK nuk ka përpunuar të dhëna të detajuara mbi numrin e zyrtarëve që nuk e kanë deklaruar pasurinë sipas kategorive të parapara me ligj, përkatësisht: me rastin e marrjes së detyrës, deklarimit të rregullt vjetor, me largim nga puna apo me kërkesë të Agjencisë. Në këtë periudhë tri vjeçare mosdeklarimi i pasurisë nga ana e zyrtarëve të lartë publik është trajtuar vetëm në aspektin administrativ, ashtu siç e kanë paraparë normat ligjore në fuqi.

**Grafikoni 1.** Të dhënat statistikore për mosdeklarim të pasurisë sipas kategorive ligjore, për vitet 2007-2014



**Burimi:** Të dhënat e përpunuara nga raportet vjetore të AKK-së<sup>16</sup>

<sup>15</sup> AKK (2010) Raporti Vjetor 2009; [http://www.ACA-ks.org/repository/docs/Raporti\\_vjetor%20i\\_Agjencise\\_kunderkorrupsionit\\_1\\_Janar\\_31\\_Dhjetor\\_2010.pdf](http://www.ACA-ks.org/repository/docs/Raporti_vjetor%20i_Agjencise_kunderkorrupsionit_1_Janar_31_Dhjetor_2010.pdf)

<sup>16</sup> Të dhënat janë përpunuar bazuar në raportet vjetore të AKK-së: <http://www.akk-ks.org/?cid=1,16>

**Tabela 1.** Statistikat e rasteve të zyrtarëve që nuk e kanë deklaruar pasurinë dhe masave të propozuara nga AKK-ja

| Viti | Numri i mosdeklaruesve | Propozim për ulje të pagës | Propozim për shkarkim nga detyra |
|------|------------------------|----------------------------|----------------------------------|
| 2007 | 14                     | 21 <sup>17</sup>           | 14                               |
| 2008 | 14                     | 31                         | 14                               |
| 2009 | 16                     | 16                         | 6                                |

**Burimi:** Raportet vjetore të AKK-së për vitet 2007-2009

Në vitin 2010, ka hyrë në fuqi Ligji për Deklarimin, Origjinën dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik,<sup>18</sup> i cili solli disa risi të vogla sa i përket entiteteve që kanë për detyrim deklarimin e pasurisë si dhe një rritje e shkallës së dënimeve materiale për shkeljen e dispozitave ligjore për mosdeklarim të pasurisë, duke e avancuar aspektin e mosdeklarimit të pasurisë nga një shkelje administrative në kundërvajtëse. Neni 16 i këtij ligji parashihte masa ndëshkuese për mosdeklarim nga 150 deri në 1,500 EUR, varësisht nga kategoria e shkeljes. Sipas raportit të Agjencisë, në vitin 2010, nga numri i përgjithshëm prej 1,560 zyrtarëve të paraparë për deklarim, **77** prej tyre kanë dështuar ta deklarojnë pasurinë dhe atë.<sup>19</sup>

- 67 zyrtarë nuk kanë deklaruar pasurinë në kategorinë e deklarimit të rregullt vjetor;
- 8 zyrtarë me rastin e marrjes së detyrës;
- 2 zyrtarë, pas kërkesës së Agjencisë;

Në zbatim të dispozitave ligjore, AKK ka iniciuar rastet në gjykata vendimet e së cilave përfshijnë gjoba në vlerë deri 1,000 EUR.

**Tabela 2.** Numri i rasteve të iniciuara nga AKK për mosdeklarim të pasurisë dhe rasteve të shqyrtuara nga gjykatat për vitin 2010

| Viti | Numri i paraparë për deklarim | Numri i rasteve të iniciuara nga AKK për mosdeklarim | Numri i rasteve të shqyrtuara nga gjykatat | Numri i të dënuarve | Shuma totale |
|------|-------------------------------|------------------------------------------------------|--------------------------------------------|---------------------|--------------|
| 2010 | 1560                          | 77                                                   | 59                                         | 45                  | 26,750 EUR   |


**Burimi:** Raporti vjetor i AKK-së për vitin 2010

<sup>17</sup> Rastet në të cilat AKK ka propozuar masën e uljes së pagës për 1/5, paraqesin masën e paraparë për ata zyrtarë të lartë publik të cilët nuk e kanë deklaruar pasurinë brenda afatit të paraparë, ndërsa masa tjetër për shkarkim nga detyra korrespondon me zyrtarët që nuk e kanë deklaruar fare pasurinë. Poashtu, është me rëndësi të sqarohet se AKK në raportet e saj nuk ka ofruar ndonjë të dhënë se çfarë ka pasuar me këto raste, dhe nëse masat e tilla janë ndërmarrë në të vërtetë.

<sup>18</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2767>

<sup>19</sup> AKK (2011) Raporti Vjetor 2010; [http://www.ACAks.org/repository/docs/Raporti\\_Vjetor\\_2010\\_janar\\_dhjetor.pdf](http://www.ACAks.org/repository/docs/Raporti_Vjetor_2010_janar_dhjetor.pdf)

**Grafikoni nr. 2:** Natyra e dënimeve të shqiptuara nga gjykatat për vitin 2010



**Burimi:** Raporti vjetor i AKK-së për vitin 2010

Siç mund të vërehet në këtë paraqitje grafike mbi natyrën e dënimeve të shqiptuara, shkalla më e lartë e tyre ishte në vlerën prej 300 EUR, shumë kjo që korrespondon me një pagë pak më të lartë se mesatarja e pagës në Kosovë, që nga aspekti cilësor i vlerësimit nuk paraqet ndonjë shumë të papërbalueshme. Ndërsa ndonëse një numër mjaft i madh i vendimeve gjyqësore janë dhënë edhe me dënime në vlerë prej 1,000 EUR, pjesa më e madhe e tyre janë reduktuar në 300 EUR apo janë pezulluar në shqyrtimin e dytë pas ankesës së palëve.<sup>20</sup>

Në shtator të vitit 2011, ka hyrë në fuqi Ligji i ri për Deklarim të Pasurisë (ligji aktual me amendamentet përcjellëse), i cili e rriti shkallën e paraparë të dënimeve materiale në rast të shkeljes së provizioneve për mosdeklarim apo deklarim të rrejshëm të pasurisë nga 1,000 minimalja deri në 2,500 EUR. Për vitin 2011, nga numri i përgjithshëm prej 1830 zyrtarësh, në kategorinë e deklarimit vjetor kanë dështuar të deklarojnë pasurinë 62 zyrtarë, ndërsa në kategorinë e deklarimit me marrjen e detyrës 20 zyrtarë nuk e kanë deklaruar pasurinë si dhe 4 të tjerë nuk e kanë deklaruar pasurinë me kërkesë të Agjencisë, që në total japin numrin prej **86** zyrtarësh që nuk i kanë përmbushur detyrimet ligjore.<sup>21</sup>

<sup>20</sup> Po aty


<sup>21</sup> AKK (2012) Raporti Vjetor 2011; [http://www.ACA-ks.org/repository/docs/Raporti\\_Vjetor\\_i\\_Punes\\_2011\\_i\\_ACA-se-VP\\_si%20pdf.pdf](http://www.ACA-ks.org/repository/docs/Raporti_Vjetor_i_Punes_2011_i_ACA-se-VP_si%20pdf.pdf);

**Tabela 3.** Numri i rasteve të iniciuara nga AKK për mosdeklarim dhe deklarim jo të plotë të pasurisë dhe rasteve të shqyrtuara nga gjykatat për vitin 2011

| Viti | Numri i paraparë për deklarim | Numri i rasteve të iniciuara nga AKK për mosdeklarim | Numri i rasteve të shqyrtuara nga gjykatat | Numri i të dënuarve | Shuma totale |
|------|-------------------------------|------------------------------------------------------|--------------------------------------------|---------------------|--------------|
| 2011 | 1830                          | 88 <sup>22</sup>                                     | 39                                         | 33                  | 14,550 EUR   |

**Burimi:** Raporti vjetor i AKK-së për vitin 2011

**Grafikoni nr. 3.** Natyra e dënimeve të shqyrtuara nga gjykatat për mosdeklarim apo deklarim jo të plotë të pasurisë për vitin 2011



**Burimi:** Raporti vjetor i AKK-së për vitin 2011

Siç mund të shohim nga krahasimi ndër vite i këtyre të dhënave, vërehet një trend i ngritjes së numrit të zyrtarëve që nuk e kanë deklaruar pasurinë pavarësisht se masat e parapara ndëshkimore janë rritur. Rasti që shënon shkallën më të lartë të mosdeklarimit paraqitet në vitin 2012, në të cilin, nga numri i përgjithshëm prej 3,656 zyrtarëve të lartë publik të paraparë për deklarim, 277 nuk e kanë deklaruar pasurinë në kategorinë e deklarimit vjetor, 18 zyrtarë nuk kanë deklaruar me rastin e marrjes së detyrës zyrtare, 11 nuk kanë deklaruar pasurinë pas kërkesës së Agjencisë,<sup>23</sup> që në total japin numrin prej **306** zyrtarësh që nuk kanë zbatuar dispozitat ligjore. Kjo ngritje kaq e madhe e numrit të mosdeklaruesve të pasurisë meriton një


<sup>22</sup> Për mosdeklarim të pasurisë janë iniciuar 86 raste ndërsa dy raste të tjera janë iniciuar për mosdeklarim të plotë të pasurisë. Për më shumë, shih raportin e punës së AKK-së për vitin 2011, faqe 26; [http://www.akk-ks.org/repository/docs/Raporti\\_Vjetor\\_i\\_Punes\\_2011\\_i\\_AKK-se-VP\\_si%20pdf.pdf](http://www.akk-ks.org/repository/docs/Raporti_Vjetor_i_Punes_2011_i_AKK-se-VP_si%20pdf.pdf)

<sup>23</sup> AKK (2013) Raporti Vjetor 2012; [http://www.ACA-ks.org/repository/docs/Raporti\\_2013-vp.pdf](http://www.ACA-ks.org/repository/docs/Raporti_2013-vp.pdf)

shqyrtim analitik rreth shkaqeve që kanë mundur të ndikojnë në këtë shifër të lartë të zyrtarëve që kanë shkelur ligjin.

Në parim duhet pranuar se numri i zyrtarëve që kanë qenë të paraparë për të deklaruar pasurinë ka shkuar duke u rritur vit pas viti ndërsa në vitin 2012, numri i përgjthshëm i deklaruesve ka qenë më i larti deri në atë kohë që do të mund të korrespononte me trendin e lartë të mosdeklaruesve, megjithatë kjo nuk përbën arsyen bazë. Një nga arsyet primare që ne i kemi identifikuar si shkak për këtë papërgjegjësi të zyrtarëve të lartë publik që kanë refuzuar ta deklarojnë pasurinë është shkalla e butë e dënimeve dhe masave ndëshkimore që gjykatat kanë dhënë në të kaluarën përkitazi me shkeljen në fjalë. Por, krahas këtij argumenti, edhe mosfunksionimi i mirëfilltë i pikave të kontaktit apo mos informimi adekuat rreth obligimeve ligjore mund të kenë ndikuar po ashtu në këtë trend të zyrtarëve që nuk e kanë deklaruar pasurinë.

**Grafikoni nr. 4.** Trendi i mosdeklaruesve të pasurisë i shprehur në përqindje (2007-2014)



**Vërejtje:** Paraqitja e statistikave në përqindje për vitet 2007-2009, të plotësuara me ngjyrë të gjelbër nënkupton rastet kur mosdeklarimi ishte shkelje administrative, kurse me ngjyrë të kaltër për vitet 2010-2012, mosdeklarimi i pasurisë ishte shkelje kundërvajtëse, ndërsa vitet 2013-2014, të plotësuara me ngjyrë të kuqe, nënkuptojnë periudhën pas penalizimit të mosdeklarimit të pasurisë

Sipas të dhënave mbi natyrën e ndëshkimeve që kanë shqiptuar gjykatat, shihet qartazi se dënimet janë të lehta dhe për më tepër, të njëjtat në shumicën e rasteve janë rishqyrtuar në procesin e apelimit, me ç'rast këto verdikte domosdo kanë kontribuar në mos ndërtimin e një bindje dhe vetëdije të mirëfilltë se moszbatimi i ligjit për deklarim të pasurisë konform neneve të parapara, do të përbënte një shkelje që nuk amnistohet, të paktën financiarisht.



Në vitin 2013, ka hyrë në fuqi Kodi Penal i Republikës së Kosovës (KPRK) i cili në nenin 437 ka paraparë si vepër penale mosdeklarimin apo deklarimin e rrejshëm të pasurisë<sup>24</sup> dhe i cili paraqet hapin e parë serioz për të fuqizuar jo vetëm masën e ndëshkimit për mosdeklarim, por edhe vetë procesin e deklarimit të pasurisë në Republikën e Kosovës. Efektet e penalizimit të mosdeklarimit të pasurisë mund të vërehen menjëherë në dy vitet e fundit. Në vitin 2013, nga numri i përgjithshëm prej 3,869 zyrtarëve të lartë publik të paraparë për deklarim, vetëm **35** kanë dështuar në këtë proces, dhe atë, 29 në deklarimin e rregullt vjetor, 1 pas marrjes së detyrës dhe 5 pas largimit nga funksioni.<sup>25</sup> Më tutje, në vitin 2014, nga numri i përgjithshëm prej 3,038, vetëm dy zyrtarë nuk e kanë deklaruar pasurinë<sup>26</sup> duke shënuar kështu shkallën më të ultë të refuzimit të deklarimit të pasurisë për sa i përket kategorisë së deklarimit vjetor.

Krahasuar me vitin 2012, vitet 2013 dhe 2014, të dhënat paraqesin një ulje drastike të mosdeklaruesve për sa i përket deklarimit të rregullt vjetor të pasurisë dhe kjo mund të interpretohet si rezultat direkt i penalizimit dhe masave ndëshkimore të parapara për mosdeklarim të cilat përveç dënimit me gjobë përfshijnë edhe dënimin me burgim. Megjithatë, kjo analizë nuk është e plotë dhe nuk mund të bëhet ndaras pa përfshirë edhe elemente të tjera që lidhen në përgjithësi me procesin e DP-së dhe që shtrojnë shumë pyetje të rëndësishme. Një nga këto lidhet me deklarimin e pasurisë për vitin 2014 apo më konkretisht, me numrin prej 41 zyrtarëve që nuk e kanë deklaruar pasurinë me rastin e marrjes së detyrës si dhe 50 zyrtarëve që nuk e kanë deklaruar pasurinë me rastin e largimit nga detyra.<sup>27</sup> Pra, në njërën anë kemi një ulje drastike të numrit të zyrtarëve që nuk e kanë deklaruar pasurinë sipas deklarimit të rregullt vjetor krahasuar me vitet tjera paraprake, ndërsa kemi një numër shumëfish më të madh të mosdeklarimit të pasurisë me rastin e marrjes së detyrës apo largimit nga detyra.

<sup>24</sup> Neni 437 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2834>

1. Çdo person, i cili sipas ligjit është i detyruar të bëjë deklarimin e pasurisë, të të ardhurave, të dhuratave, të dobisë tjetër pasurore ose të detyrimeve financiare, dhe i cili nuk bën një gjë të tillë, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet. Vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni konsiderohet se është kryer kur deklarata nuk paraqitet brenda afatit për paraqitjen e deklaratës.

2. Çdo person, i cili sipas ligjit është i detyruar të bëjë deklarimin e pasurisë, të të ardhurave, të dhuratave, të dobisë tjetër pasurore ose të detyrimeve financiare, i cili falsifikon ose nuk paraqet të dhënat e kërkuara në deklaratë, dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.


3. Vlera e padeklaruar e pasurisë, të të ardhurave ose të dobisë tjetër pasurore, e cila është fituar në mënyrë joligjore konfiskohet.

<sup>25</sup> AKK (2014) Raporti Vjetor 2013; <http://www.ACA-ks.org/repository/docs/Raporti-01-Janar-31-Dhjetor-2013-verzioni-shqip.pdf>

<sup>26</sup> AKK (2015) Raporti Vjetor 2014; [http://www.ACA-ks.org/repository/docs/Raporti\\_vjetor\\_final\\_2014\\_sq.pdf](http://www.ACA-ks.org/repository/docs/Raporti_vjetor_final_2014_sq.pdf)

<sup>27</sup> Po aty;

**Grafikoni nr 5.** Paraqitja grafike e trendit të mosdeklarimit të pasurisë, 2007-2014




**Burimi:** Raportet vjetore të AKK-së, (2007-2014)

**Vërejtje:** Paraqitja e statistikave në përqindje për vitet 2007-2009, të plotësuara me ngjyrë të gjelbër nënkupton rastet kur mosdeklarimi ishte shkelje administrative, kurse me ngjyrë të kaltër për vitet 2010-2012, mosdeklarimi i pasurisë ishte shkelje kundërvajtëse, ndërsa vitet 2013-2014, të plotësuara me ngjyrë të kuqe, nënkuptojnë periudhën pas penalizimit të mosdeklarimit të pasurisë

Përveç kësaj, edhe në vitin 2015 kemi një shpërputhje logjike që ia vlen të merret në konsideratë. Të dhënat e mëposhtme paraqesin numrin e zyrtarëve që nuk e kanë deklaruar pasurinë në afatin e rregullt për vitin 2015, krahasuar me vitet 2013, dhe 2014.

**Grafikoni nr.6.** Deklarimi i pasurisë brenda afatit ligjor deri më 31 mars 2015, krahasuar me vitet paraprake



**Burimi:** AKK Lista e Zyrtarëve që nuk e kanë deklaruar pasurinë në afatin e rregullt për vitin 2015 dhe raportet vjetore për vitet 2013, 2014

Nëse supozojmë që përqindja e lartë e deklarimit të pasurisë në kategorinë e rregullt vjetore për vitet 2013-2014, ka ardhur si rezultat i penalizimit të mosdeklarimit të pasurisë, atëherë penalizimi kushtimisht do të përfshinte edhe kategoritë tjera të deklarimit të pasurisë. Posaçërisht ky fakt do të duhet të ndikonte edhe në uljen drastike të numrit të zyrtarëve që nuk e kanë deklaruar pasurinë në afatin e rregullt vjetor edhe në vitin 2015. Kjo mospërputhje logjike e argumentit sipas gjykimit tonë është shkak edhe i aspekteve të tjera që lidhen me sistemin në tërësi, dhe me metodologjinë e punës së AKK-së në veçanti.


Përgjithësisht, i vetmi argument i ofruar nga AKK-ja përkitazi me rritjen e numrit të zyrtarëve që kanë refuzuar ta deklarojnë pasurinë për vitin 2015 (**71 zyrtarë të lartë publik nga të cilët 33 deklarues për herë të parë**), marrin për referencë shkallën e ultë të dënimeve të lëshuara nga gjykatat. Një argument i tillë, edhe pse me ndikim shumë të theksuar, nuk është i plotë duke qenë se nuk është i vetmi në gamën e gjerë të shkaqeve që mund të kenë çuar në rritje të numrit zyrtarëve që nuk e deklarojnë pasurinë. Me fjalë të tjera, Çohu! ka arritur të identifikojë disa zbrazëtira në sistemin e DP-së, për të cilat Agjencia e bartë një pjesë të përgjegjësisë, paralelisht me institucionet dhe mekanizmat tjera siç janë gjykatat dhe prokuroritë, të cilat janë të elaboruara në kapitullin e shtatë.

## 5. Të gjeturat empirike të hulumtimit rreth vërtetësisë së të dhënave të deklaruara

Organizata Çohu! në kontributin e saj për institucione publike me integritet i ka kushtuar rëndësi të veçantë saktësisë së të dhënave të deklaruara nga zyrtarët e lartë publik. Në këtë kuadër, pas publikimit të listës së 20% të zyrtarëve të lartë publik që i janë nënshtruar kontrollit të plotë në vitin 2014, apo 584 formularë të pasurisë,<sup>28</sup> AKK-ja ka gjetur mospërputhje në 187 raste për të cilat ka kërkuar sqarim, ndërsa ka inicuar 77 raste për konflikt të mundshëm të interesit, ndërsa 11 raste janë përcjellë për kallëzim penal.

Mbi bazën e kësaj liste të publikuar për kontrollin e plotë, Çohu! ka ndërmarrë një hulumtim empirik vetanak të krahasimit të të dhënave të deklaruara për gjithsej 199 zyrtarë. Të dhënat në regjistrat e deklarimit të pasurisë së këtyre zyrtarëve në fjalë janë krahasuar me institucionet tjera publike siç është Agjencioni për Regjistrimin e Bizneseve (ARBK) dhe zyret e kadastrit në disa komuna të Republikës së Kosovës. Nga gjithsej 199 kërkesa, Çohu!, ka pranuar të dhëna nga zyrat kadastrale për gjithsej 44 zyrtarë të lartë publik.<sup>29</sup> Nga këto të dhëna të siguruar, Çohu! ka gjetur që në **8** raste ka mospërputhje dhe pasaktësi në deklarimin e pronave dhe pasurisë së patundshme krahasuar me të dhënat e siguruar nga kadastri dhe të dhënat e deklaruara në regjistrat e pasurisë së AKK-së.<sup>30</sup>

**Grafikoni nr 7.** Mospërputhja mes regjistrave të AKK-së dhe të dhënave të kadastrit



**Burimi:** Hulumtim nga Çohu! i krahasimit të të dhënave nga regjistrat e pasurisë dhe kadastrave komunale

<sup>28</sup> AKK: Lista e Zyrtarëve për kontrollin e plotë për vitin 2014: [http://akk-ks.org/repository/docs/Lista\\_perzgjedhese.pdf](http://akk-ks.org/repository/docs/Lista_perzgjedhese.pdf)


<sup>29</sup> Vendimet për qasje në dokumentat zyrtarë janë lëshuar për Qendrën Kosovare për Gazetari Hulumtuese - Preportr, që funksionojnë në kuadër të organizatës Çohu!

<sup>30</sup> Qendra Kosovare për Gazetari Hulumtuese - QKGH; Besnik Boletini dhe Leonida Molliqaj; "M'rrojte, t'rrojta - Brisku i Hasanit", Prill, 2015. <http://www.preportr.com/sq/Re-publika/Mrrojte-trrojta-brisku-i-Hasanit-397>

Në rrafshin tjetër, atë të bizneseve të poseduara, të gjeturat flasin për **3** raste në të cilat nuk janë deklaruar këto biznese nga ana e zyrtarëve të lartë publik. Po ashtu janë vërejtur se **4** zyrtarë të lartë publik nuk i kanë deklaruar bizneset e tyre në periudhën e paraparë me ligj (31 mars, 2014) me arsyetimin se të njëjtat nuk janë aktive apo se këta të fundit nuk i menaxhojnë ato edhe pse ligji është shprehimisht i qartë se të njëjtat duhet të deklarohen.<sup>31</sup>

Një e dhënë tjetër e rëndësishme nga hulumtimi është pasaktësia në deklarimin e kategorisë së bizneseve dhe të hyrave, me ç'rast kemi gjetur që 4 zyrtarë të lartë publik nuk i kanë deklaruar bizneset ndërsa kanë deklaruar të hyrat nga to, duke e bërë të pamundur kështu identifikimin e lidhjes së tyre me këto biznese në fjalë. Më fjalë të tjera, sipas regjistrave të pasurisë, nuk është e qartë se çfarë raporti kanë zyrtarët e lartë me këto biznese nga të cilat marrin të hyra, nëse ata janë pronarë, bashkëpronarë, kanë aksione apo kryejnë edhe ndonjë shërbim tjetër profesional e të konsulencës. Hulumtimi ka treguar se të **4** zyrtarët janë edhe pronarë në këto biznese.<sup>32</sup>

**Grafikoni nr 8.** Rastet e mospërputhjes së deklarimit dhe mosdeklarimit të aseteve



**Burimi:** Hulumtim vetanak i Çohu! bazuar në krahasimin e të dhënave të marra nga regjistrat e pasurisë në AKK, me të dhëna të siguruar nga ARBK

Të dhënat nga hulumtimi empirik tregojnë për segmente të caktuara ku ka mospërputhje në mes të aseteve të deklaruar siç është paraparë me ligj dhe formës siç janë deklaruar në regjistra. Për më tepër, ka pasaktësi të dhënash të cilat AKK-ja do të ishte dashur t'i verifikonte dhe të ndërmernte masat e parapara. Këto pasaktësi krijohen si pasojë e gabimeve materiale dhe mos'harmonizimit të regjistrave, por edhe mënyrës se si AKK konsideron se duhet

<sup>31</sup> Po aty.

<sup>32</sup> Po aty.

plotësuar regjistrat e pasurisë, ku në shumë raste, zyrtarët e lartë publik deklarojnë asetet në mënyrë të përgjysmuar. Deklarimet e tilla problematike që ne i kemi identifikuar janë ato që lidhen me vlerën e kredisë, datën e marrjes së saj dhe datën e përfundimit, siç kemi pasur rast të shohim edhe në regjistrin e pasurisë së vetë udhëheqësit të AKK-së,<sup>33</sup> i cili në deklarinë e vitit 2011, kredinë e paraqet pa datë të marrjes dhe përfundimit por vetëm vitet brenda të cilave kredia duhet të kthehet, gjithsej 6, ndonëse në vitet në vazhdim evoluon duke e paraqitur datën e marrjes dhe datën e përfundimit të saj. Megjithatë udhëheqësi i AKK-së në vitet vijuese ka paraqitur kredinë sipas standardit të aplikueshëm, prapë se prapë AKK-ja, ka toleruar përjashtime të kësaj natyre, përkatësisht në rastin tek ish Kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi,<sup>34</sup> në regjistrat e pasurisë të të cilit tregohet vetëm shuma totale e kredisë së marrë, pa datën se kur është marrë dhe kur përfundon si dhe pa të dhëna për shlyerjen e saj.

Ndonëse në Udhëzuesin Praktik për Luftimin dhe Parandalimin e Korrupsionit të publikuar nga AKK-ja në vitin 2015,<sup>35</sup> ky aspekt është tentuar të standardizohet, me ç'rast kërkohet paraqitja e saktë e datës së marrjes dhe datës së përfundimit të kredisë si dhe shumës së kredisë, Çohu!, e konsideron këtë si një masë të pamjaftueshme, sepse e njëjta pamundëson çfarëdo verifikimi aritmetik nga një vlerësues i jashtëm, për shkak se nuk është paraparë edhe një shtyllë tjetër e rëndësishme. Fjala është për planin e amortizimit të kredisë vit pas viti, për shkak se mosparaqitja e vlerës së zbritur të kredisë apo saktësimi se sa ka qenë detyrimi ndaj bankës në vitin paraprak dhe sa është tani, pamundëson verifikimin aritmetik, dhe nuk dihet nëse zyrtari ka shlyer detyrimet ndaj bankës, apo ka aranzhuar marrëveshje tjetër me bankën dhe mund të mos dihet se si është shlyer ajo dhe nga cilat burime është shlyer.

<sup>33</sup> AKK: Deklarimi i Pasurisë, Hasan Preteni, 2011. [http://akk-ks.org/2011/Institucionet\\_e\\_Pavarura\\_te\\_Republikes\\_se\\_Kosoves/Agjencia\\_Kunder\\_Korrupsionit/Hasan\\_Preteni.pdf](http://akk-ks.org/2011/Institucionet_e_Pavarura_te_Republikes_se_Kosoves/Agjencia_Kunder_Korrupsionit/Hasan_Preteni.pdf); Tek ky rast shihet deklarimi i kredisë për 6 vite, pa datë se kur fillon apo kur mbaron; Në vitin 2012, Preteni deklaroi kredinë e njëjtë pa zbritur shumën: [http://akk-ks.org/2012/Institucionet\\_e\\_Pavarura/Agjencia\\_kunder\\_Korrupsionit/Hasan\\_Preteni.pdf](http://akk-ks.org/2012/Institucionet_e_Pavarura/Agjencia_kunder_Korrupsionit/Hasan_Preteni.pdf)

AKK: Deklarimi i Pasurisë, Hasan Preteni, 2013; [http://akk-ks.org/2013/Institucionet\\_e\\_Pavarura/Agjencia\\_kunder\\_Korrupsionit/Hasan\\_Preteni.pdf](http://akk-ks.org/2013/Institucionet_e_Pavarura/Agjencia_kunder_Korrupsionit/Hasan_Preteni.pdf) deklarim pa zbritur shumën.

AKK: Deklarimi i Pasurisë, Hasan Preteni, 2014; [http://akk-ks.org/2014/Agjencite\\_e\\_Pavarura/Agjencia\\_kunder\\_Korrupsionit/Hasan\\_Preteni.pdf](http://akk-ks.org/2014/Agjencite_e_Pavarura/Agjencia_kunder_Korrupsionit/Hasan_Preteni.pdf); deklarim pa zbritur shumën.

AKK: Deklarimi i Pasurisë, Hasan Preteni, 2015; [http://akk-ks.org/2015/Institucionet\\_e\\_Pavarura/Agjencia\\_kunder\\_Korrupsionit/Hasan\\_Preteni.pdf](http://akk-ks.org/2015/Institucionet_e_Pavarura/Agjencia_kunder_Korrupsionit/Hasan_Preteni.pdf)

<sup>34</sup> AKK: Deklarimi i Pasurisë, Hashim Thaçi, 2010; [http://akk-ks.org/2010/Qeveria%20e\\_Republikes\\_se\\_Kosoves/Zyra\\_e\\_Kryeministrit\\_te\\_Republikes\\_se\\_Kosoves/Zyrtaret\\_e\\_Larte\\_ne\\_ZKM/2010\\_Hashim%20Thaci-Kryeminister%20i%20Republikes%20se%20Kosoves.pdf](http://akk-ks.org/2010/Qeveria%20e_Republikes_se_Kosoves/Zyra_e_Kryeministrit_te_Republikes_se_Kosoves/Zyrtaret_e_Larte_ne_ZKM/2010_Hashim%20Thaci-Kryeminister%20i%20Republikes%20se%20Kosoves.pdf); Deklarimi i Pasurisë, Hashim Thaçi, 2011; [http://akk-ks.org/2011/Qeveria\\_e\\_Republikes\\_se\\_Kosoves/Zyra\\_e\\_Kryeministrit\\_te\\_Republikes\\_se\\_Kosoves/Hashim\\_Thaci.pdf](http://akk-ks.org/2011/Qeveria_e_Republikes_se_Kosoves/Zyra_e_Kryeministrit_te_Republikes_se_Kosoves/Hashim_Thaci.pdf) Deklarimi i Pasurisë, Hashim Thaçi, 2012; [http://akk-ks.org/2012/Qeveria/Zyra\\_e\\_Kryeministrit\\_te\\_Republikes\\_se\\_Kosoves/Hashim\\_Thaci.pdf](http://akk-ks.org/2012/Qeveria/Zyra_e_Kryeministrit_te_Republikes_se_Kosoves/Hashim_Thaci.pdf)

Deklarimi i Pasurisë, Hashim Thaçi, 2013; [http://akk-ks.org/2013/qeveria/Zyra\\_e\\_Kryeministrit\\_te\\_Republikes\\_se\\_Kosoves/Hashim\\_Thaci.pdf](http://akk-ks.org/2013/qeveria/Zyra_e_Kryeministrit_te_Republikes_se_Kosoves/Hashim_Thaci.pdf)

Deklarimi i Pasurisë, Hashim Thaçi, 2014; [http://akk-ks.org/2014/Qeveria/Zyra\\_e\\_Kryeministrit\\_te\\_Republikes\\_se\\_Kosoves/Hashim\\_Thaci.pdf](http://akk-ks.org/2014/Qeveria/Zyra_e_Kryeministrit_te_Republikes_se_Kosoves/Hashim_Thaci.pdf) Deklarimi i Pasurisë, Hashim Thaçi, 2015; [http://akk-ks.org/2015/Qeveria/Ministria\\_e\\_Puneve\\_te\\_Jashtme/Hashim\\_Thaci.pdf](http://akk-ks.org/2015/Qeveria/Ministria_e_Puneve_te_Jashtme/Hashim_Thaci.pdf)

<sup>35</sup> AKK (2015), Udhëzues Praktik nga Fusha e Parandalimit dhe Luftimit të Korrupsionit: [http://www.akk-ks.org/repository/docs/udhezimi%20shqip%20finale%20\(4\).pdf](http://www.akk-ks.org/repository/docs/udhezimi%20shqip%20finale%20(4).pdf);

Poashtu, hulumtimi tregon edhe për probleme të tjera me regjistrat siç është deklarimi i të hyrave nga bizneset pa deklaruar lidhjen që zyrtari ka me biznese, apo mos specifikimi adekuat i natyrës së aseteve të lëvizshme dhe në vlerë mbi 3,000 EUR pa indikacione që do të mund të analizoheshin mbi vlerën e tregut aktual. Këto paraqesin disa probleme që figurojnë nga hulumtimi empirik, dhe që tregojnë për moszbatimin e duhur të hetimit paraprak, konkretisht kontrollin e aspektit teknik e material nga ana e AKK-së.

Këto vakume dhe mungesa të qasjes së AKK-së, në analiza përmbajtësore të kësaj natyre e pamundësojnë vlefshmërinë e të dhënave dhe saktësinë e tyre deri në atë shkallë që të tolerohen shkeljet e precizuara me Ligjin për Deklarim të Pasurisë dhe të sanksionuara me Kodin Penal të Kosovës. Kjo natyrë e problemeve na sjellë para dy problemeve:

- **Së pari**, mungesa e harmonizimit të regjistrave pamundëson analizën mbi gjendjen reale të pasurisë së zyrtarëve të lartë publik, dhe;
- **Së dyti**, mos-saktësimi i vlerës së kredisë dhe posaçërisht amortizimit të saj, pamundëson një analizë të mirëfilltë aritmetike mbi relacionin e pasurive të deklaruara dhe të hyrave të zyrtarit të lartë publik. Specifikimi i gjendjes reale të obligimeve kundrejt institucioneve kreditore në regjistrat e pasurisë ka një rëndësi themelore për të kuptuar raportin e interesave të një zyrtari të lartë publik, nëse ka shlyer pjesën e paraparë të borxhit, dhe nëse po, nga cilat të ardhura e ka shlyer.

Një aspekt me rëndësi në tërë çështjen e mos-deklarimit apo të deklarimit të rrejshëm të pasurisë është edhe fakti se numri i zyrtarëve të lartë publik që kanë refuzuar t'u përgjigjen kërkesave ligjore në këtë drejtim ka ekzistuar në masë të madhe si para penalizimit<sup>36</sup> ashtu sikur që po vazhdon të jetë edhe tani pas penalizimit, pavarësisht pritjeve që penalizimi i mosdeklarimit dhe deklarimit të rrejshëm të pasurisë do të arrijë efekte konkrete në uljen e kësaj dukurie. Pra, edhe përkundër ashpërsimit të masave ndëshkuese për mosdeklarim apo deklarim të rrejshëm të pasurisë, trendi i mosdeklarimit apo deklarimit të rrejshëm të pasurisë ende vazhdon të mbetet i lartë dhe do të duhej të shihej me shqetësim.

Paraqitja e problemeve materiale me regjistra, mosplotësimi i duhur apo i pjesshëm i regjistrave dhe fshehja e të dhënave mbi pronësinë e bizneseve apo të ardhurave nga to, mbi pronësinë e pronave të patundshme, si dhe paqartësitë mbi obligimet reale të kredive të zyrtarëve të lartë publik nëpër bankat e Kosovës si pasojë e deklarimit të shumës së kredisë por jo edhe amortizimit të saj, siç tregon hulumtimi i Çohu!-të, janë indikatorë që një verifikim dhe

---

<sup>36</sup> Qendra Kosovare për Gazetari Hulumtuese – QKGH, "Shtatë deputetë fshehin pasurinë", Besnik Boletini, dhjetor, 2011;

<http://www.preportr.com/sq/Re-publika/Shtat-deputet-fshehin-pasurin-68>

Qendra Kosovare për Gazetari Hulumtuese – QKGH, "Sa për sy e faqe", Besnik Boletini, prill 2012;

<http://www.preportr.com/sq/Re-publika/Sa-pr-sy-e-faqe-94>

vlerësim i paanshëm nga jashtë, përkatësisht nga shoqëria civile, por edhe vetë AKK-ja, është pothuajse i pamundur.

Rrjedhimisht, këto probleme përmbajtësore, por edhe materiale e teknike, paraqesin bazë për interpretim të dyanshëm të formës së deklarimit, pasi që në njërën anë ekziston arsyetimi i zyrtarëve rreth gabimit të paqëllimshëm apo nga mosnjohuritë përkatëse, ndërsa në anën tjetër të njëjtat mund të interpretohen si shkelje ligjore që do të duhej të merreshin në konsideratë. Kjo natyrë e dykuptimisë paraqet një problem edhe në vetë rastet e gjykimit kundër mosdeklarimit apo deklarimit të rrejshëm të pasurisë, për të cilat do të flitet më tutje.

Një aspekt i rëndësishëm në procesin e deklarimit të pasurisë është mekanizmi i kontrollit të plotë. Ndonëse ka vetëm një vit që realizohet dhe ende nuk mund të shihet qartë efekti i tij, pritjet janë të mëdha që ky instrument i kontrollit do të bëjë një dallim real në luftën kundër korrupsionit. Në vitin 2014, nga 20% e zyrtarëve që i janë nënshtruar kontrollit të plotë, apo dhënë në numër, gjithësej 598 formularë të pasurisë, AKK-ja ka paraqitur kallëzime penale për 11 zyrtarë, si pjesë e gjetjeve të saja rreth deklarimit të rrejshëm të pasurisë.<sup>37</sup>

Megjithatë, një e metë e mënyrës së raportimit të statistikave mbi kontrollin e plotë është evidente. Në raportin vjetor të 2014, theksohet se në prokurori janë përcjellur gjithësej 101 raste për shkelje të nenit 437 të KPRK-së, nga të cilat 93 raste për mosdeklarim të pasurisë në afatin e rregullt vjetor ndërsa 8 raste për deklarim të rrejshëm të pasurisë (paragrafi 2 i nenit 437 të KPRK-së).<sup>38</sup> Në këtë rast, shihet që ka dallim nga numri i procesimit në prokurori nga 11 rastet e theksuara më lartë në 8 të theksuara më tutje në raport, dhe kjo për faktin se konstatimi i rasteve në fjalë lidhet me kontrollin e plotë, pra këto shifra derivojnë nga kontrolli i plotë dhe si të tilla janë kontradiktore.

Për më tepër, raporti vjetor i AKK-së, përveç ndarjes statistikore (ndonëse konfuze), nuk paraqet asnjë të dhënë tjetër substanciale, përkitazi informacion shtesë rreth natyrës së gjetjeve që kanë rezultuar nga kontrolli i plotë i pasurisë të 20% të zyrtarëve të lartë publik. Ky informacion apo përshkrim shtesë rreth natyrës së gjetjeve përkitazi me deklarimin e rrejshëm të pasurisë bëhet edhe më relevant kur kemi parasysh se disa raste (rastet e deputetëve Nait Hasani dhe Duda Balje) të cilat AKK i ka kodifikuar si deklarim të rrejshëm të pasurisë janë hedhur poshtë nga gjykatat.

---

<sup>37</sup> AKK (2014) Raporti Vjetor: [http://www.akk-ks.org/repository/docs/Raporti\\_vjetor\\_final\\_2014\\_sq.pdf](http://www.akk-ks.org/repository/docs/Raporti_vjetor_final_2014_sq.pdf)

<sup>38</sup> Po aty,



### 5.1 Deklarimi dhe kontrolli i pasurisë së zyrtarëve të AKK-së

Gjatë vitit 2014, vetë drejtori i AKK-së Preteni, kishte rastisur të jetë në mesin e 20% të zyrtarëve publik që i janë nënshtruar kontrollit të plotë të pasurisë. Është vështirë t'i besohet mekanizmit të deklarimit dhe kontrollit të pasurisë së zyrtarëve të AKK-së për disa arsye, prej të cilave kryefjala është fakti që deri më tani, zyrtarët e AKK-së e kanë deklaruar dhe "kontrolluar" vetë pasurinë e tyre. Ndonëse në ligjin për AKK-në,<sup>39</sup> është e rregulluar që Komisioni Mbikëqyrës për AKK-në, të bartë përgjegjësitë për të pranuar formularët dhe për të kontrolluar pasurinë e zyrtarëve të Agjencisë, një gjë e tillë nuk ka ndodhur pasi një komision mbikëqyrës nuk është themeluar asnjëherë. Kjo mbikëqyrje është menduar të arrihet përmes Komisionit për Legjislacion, të cilit i kanë kaluar përgjegjësitë për mbikëqyrjen e punës së AKK-së. Megjithatë, ndonëse të paraparë me ligj për të deklaruar pasurinë e tyre pranë Komisionit Parlamentar për Legjislacion, zyrtarët e AKK-së nuk e kanë bërë një gjë të tillë.<sup>40</sup> Përgjashtuar vitin 2011 ku pas kërkesës së Organizatës Çohu!, zyrtarët e AKK-së kanë dorëzuar formularët e pasurisë tek komisioni përkatës, në vitin 2010, 2012, 2013, 2014, AKK-ja nuk ka dorëzuar formularët e pasurisë tek komisioni përkatës dhe me këtë rast ka vetëdeklaruar dhe vetëkontrolluar pasurinë e saj, duke bërë automatikisht publikimin e regjistrave të pasurisë.

Ndonëse ushtrimi i funksionit ligjor nga ana e Komisionit Parlamentar për AKK-në, në mbikëqyrjen e pasurisë së zyrtarëve të Agjencisë, paraqet konflikt të hapur të interesit për shkak se këto dy mekanizma institucionale janë në të njëjtën kohë mbikëqyrëse të pasurisë së njëri tjetrit, megjithatë as kjo masë nuk është realizuar. Në këtë rrethanë, një rishqyrtim i modelit për deklarimin e pasurisë së zyrtarëve të AKK-së në mënyrë permanente, do të duhej të ishte pjesë e debatit mbi procesin e deklarimit të pasurisë në tërësi.

---

<sup>39</sup> Ligji nr. 03/L -159, për Agjencinë Kundër Korrupsionit, neni 14; [http://www.akk-ks.org/repository/docs/Ligji\\_per\\_Agjencine\\_kunder\\_Korrupsionit\\_nr\\_03\\_L\\_159.pdf](http://www.akk-ks.org/repository/docs/Ligji_per_Agjencine_kunder_Korrupsionit_nr_03_L_159.pdf)

<sup>40</sup> Qendra Kosovare për Gazetari Hulumtuese – QKGH; Leonida Molliqaj; "Kush e kontrollon pasurinë e Hasan Pretenit?!" Korrik, 2014; <http://preportr.com/sq/I-Report/Kush-e-kontrollon-pasurin-e-Hasan-Pretenit-383>

## 6. Kundërvajtjet dhe Masat Ndëshkuese

---

Për të kuptuar shkallën e implementimit të legjislacionit dhe për të kuptuar trendin e mosdeklarimit, por edhe të deklarimit të rrejtshëm të pasurisë, siç janë paraqitur më lartë, është e domosdoshme të kuptohen shkaqet që kanë mundur të ndikojnë në këtë trend. Më saktësisht në këtë pjesë do të shqyrtojmë masat e marra ndaj shkelësve të ligjit për deklarim të pasurisë dhe efektet që ato mund të kenë prodhuar, duke ndikuar kështu në imazhin e procesit të deklarimit të pasurisë.

Në vitet 2007-2009, ligji<sup>41</sup> që qeveriste procesin e deklarimit të aseteve nuk parashihte masat ndëshkuese me gjobë por parashihte vetëm dy masa themelore:

- a) Uljen e pagës për 1/5; dhe
- b) Propozimin për shkarkim nga detyra;

Duke iu referuar statistikave zyrtare mbi numrin e mosdeklaruesve të dhëna më lartë, mund të kuptojmë se masat e parapara nuk kanë pasur ndonjë efekt sepse trendi i mosdeklaruesve nga 2007 deri në 2009 ka shkuar duke u rritur. Pas ndryshimeve në kornizën ligjore në vitin 2010 dhe miratimit të ligjit të parë që ekskluzivisht i dedikohet deklarimit të pasurisë, u shtuan edhe masat e parapara ndëshkuese për mosdeklaruesit, të cilat parashihnin dënime me gjoba nga 150 deri në 1,000 EUR por efektet e kësaj mase të re poashtu nuk u treguan të duhura pasi që trendi i mosdeklaruesve edhe për dy vitet në vijim u rrit masivisht. Në vitin 2011, u miratua Ligji aktual për deklarimin e pasurisë i cili parashihte rritjen e shkallës së gjobës nga 1,000 minimumi deri në 2,500 EUR. As kjo masë e re nuk u tregua parandaluese, veçanërisht nëse kemi parasysh se në vitin 2012, numri i mosdeklaruesve të pasurisë shënoi rritjen më të madhe deri më tani.

Nga kjo rrjedhë mund të kuptojmë se masat e parapara me dënime administrative dhe dënime me gjobë nuk kanë pasur asnjë efekt real në uljen e numrit të shkelësve të dispozitave ligjore për deklarim. Nëse kësaj ia shtojmë edhe faktin që shumica e dënimeve të dhëna nga gjykatat e shkallës së parë janë rishikuar gjatë apelit dhe janë reduktuar ndjeshëm, mund të konstatojmë se dënimet me gjobë në vlera të ulëta nuk janë konsideruar si pengesa nga ana e zyrtarëve të lartë publik për të mos deklaruar pasurinë e tyre. Logjikisht kjo qasje na bën të kuptojmë se një zyrtar që ka pasuri të pashpjegueshme, e ka pasur më të lehtë të përballojë gjobën e paraparë me ligj sesa të detyrohet të deklarojë pasurinë e cila do të mund të hapte dyshime mbi prejardhjen e saj. Deri në këtë fazë, përkatësisht deri në vitin 2012, ne konsiderojmë se arsyet për mosdeklarim nuk kanë të bëjnë shumë me gjykimet dhe trendin e ultë të dënimeve aq sa

---

<sup>41</sup> Ligji nr. 2004/34 Kundër Korrupsionit, neni 43;

kanë të bëjnë me ligjet e dobëta dhe masat e dobëta që këto ligje parashihnin për mosdeklaruesit.

Mirëpo e tërë situata ndryshon apo të paktën do të duhej të ndryshonte me rastin e hyrjes në fuqi të Kodit Penal të Kosovës në Janar 2013, me ç'rast në nenin 437 shprehimisht penalizohet mosdeklarimi apo deklarimi i rremë i pasurisë, ku për një vepër të tillë parashiheshin dënime me gjobë dhe me burgim nga 6 muaj deri në 5 vite varësisht nga kategoria e shkeljes. Nëse i referohemi statistikave të mosdeklaruesve të pasurisë, posaçërisht në kategorinë e deklarimit të rregullt vjetor në vitin 2013 dhe 2014, atëherë është e qartë se këto masa të parapara me Kodin Penal, të cilat janë harmonizuar pastaj me amendamentet përkatëse të Ligjit për Deklarim të Pasurisë, kanë dhënë efekte të drejtpërdrejta. Ideja se një zyrtar i lartë publik mund të dënohet me burgim për mosdeklarim apo deklarim të rrejshëm të pasurisë duhet të ketë qenë shkak kryesor i ngritjes së përgjegjshmërisë së zyrtarëve në aspektin e deklarimit të rregullt vjetor të pasurisë.

Megjithatë, ekziston edhe në këtë rrafsh një aspekt që duket shqetësues dhe jo shumë shpresëdhënës. Shkalla e vendimeve gjyqësore përkitazi me nenin 437 të KPRK-së, ka qenë kontraverse dhe sipas mendimit tonë, shpesh herë vendimet duket që nuk janë bazuar në dispozitat e nenit të Kodit Penal. Më tutje do të ofrohen statistika që e trajtojnë këtë problem për vitet 2013 dhe 2014.

**Tabela 4.** Rastet e procesuara nga AKK-ja për vitet 2013-2014 për shkelje të Ligjit për Deklarim të Pasurisë përkitazi me nenin 437 të KPRK-së

| Viti          | Lëndët llogaritur në persona sipas Prokurorisë së Shtetit |
|---------------|-----------------------------------------------------------|
| 2013          | 38 persona                                                |
| 2014          | 125 persona                                               |
| <b>TOTALI</b> | <b>163</b>                                                |

**Burimi:** Të dhënat për rastet e dërguara nga AKK-ja në prokuroritë publike janë marrë nga Prokuroria e Shtetit, kjo për arsye të mos mundësisë për komunikim me AKK, ose refuzimin e kësaj të fundit për bashkëpunim dhe komunikim.

**Vërejtje:** Shifrat në tabelë tregojnë persona e jo kallëzime penale

Nga kjo paraqitje tabelore e të dhënave figuron që për shkelje të nenit në fjalë AKK-ja ka iniciuar kallëzime për 163 zyrtarë. Mirëpo këtu mund të vërehet një paqartësi për shkak se nëse i referohemi numrit të përgjithshëm të mosdeklaruesve të pasurisë që është e dënueshme sipas nenit 437, për dy vitet në fjalë sipas statistikave zyrtare të AKK-së, janë gjithsej 128 zyrtarë që nuk e kanë deklaruar pasurinë dhe me këtë rast nuk bëhet e qartë prej nga rrjedh numri prej 163 personave. Ky numër mund të jetë rritur duke pasur parasysh se AKK-ja me rastin e kontrollit të plotë të ketë vërejtur se ka zyrtarë që nuk e kanë deklaruar saktë pasurinë, megjithatë një gjë e tillë nuk mund të konfirmohet për shkak se AKK-ja nuk ka qenë e gatshme

për bashkëpunim për të sqaruar rastet në fjalë. Kjo qasje iu pamundëson akterëve siç është shoqëria civile që të ndërmarrë analiza të mirëfillta dhe vështirëson qasjen përmbajtësore në informatat e nevojshme në mënyrë që të konstatojë dhe vlerësojë nga ana e saj punën e institucioneve dhe gjendjen faktike të luftimit të korrupsionit.

Në anën tjetër, tabela e mëposhtme tregon për numrin e rasteve të trajtuara nga prokuroritë për shkelje të nenit 437 për vitet 2013-2014:

**Tabela 5:** Prokuroritë Publike 2013-2014, rastet e trajtuara për shkelje të nenit 437 të Kodit Penal të Kosovës

| Viti          | Aktakuzë për dhënie të urdhrit ndëshkimor | Aktakuzë e drejtpërdrejtë | Aktakuzë pas hetimeve | TOTALI    |
|---------------|-------------------------------------------|---------------------------|-----------------------|-----------|
| 2013          | 2                                         | 17                        | 12                    | 31        |
| 2014          | 3                                         | 15                        | 46                    | 64        |
| <b>TOTALI</b> | <b>5</b>                                  | <b>32</b>                 | <b>58</b>             | <b>95</b> |

**Burimi:** Prokuroria e Shtetit

Në tabelën e mësipërme janë lëndët e shqyrtuara nga prokuroritë publike, të cilat përfaqësojnë raste dhe jo persona. Ajo që mund të vërehet në këtë tabelë është numri prej gjithsej 95 aktakuzash të ngritura. Por në kategorizimin e aktakuzave vërehet se për dy vitet në fjalë janë ngritur 5 aktakuza për dhënie të urdhrit ndëshkimor, masë kjo e pakuptimtë dhe që bie ndesh me Kodin Penal, për shkak se i njëjti nuk lejon fare hapësirë për shqiptimin e masave të tilla. Kodi Penal në nenin 437 lejon vetëm shqiptimin e dënimit më burgim dhe atë me gjobë si dënim plotësues, po nuk lejon fare hapësirë për shqiptim të dënimeve alternative, siç është rekomanduar në këtë rast nga prokuroria.

Aspekti më problematik i zbatimit të mirëfilltë të legjislacionit në fjalë haset tek shqyrtimi i rasteve për shkelje të dispozitave ligjore për mosdeklarim apo deklarim të rrejshëm të pasurisë nga ana e gjykatave. Më poshtë në tabelën nr.3 janë të paraqitura rastet e trajtuara nga gjykatat përkitazi me shkeljen e nenit 437 të Kodit Penal për vitet 2013-2014.

## Analizë - Deklarimi i Pasurisë: Kontrolli dhe Vërtetësia e të Dhënave

**Tabela nr. 6:** Rastet e shqyrtimit nga gjykatat për shkeljen e nenit 437 të Kodit Penal për vitet 2013-2014

|                              | <u>Lëndë në punë</u> | <u>Dënim me burgim</u> | <u>Dënim me gjobë</u> | <u>Dënim me kusht</u> | <u>Me aktgjykim lirues</u> | <u>Me aktgjykim refuzues</u> | <u>Është zgjedhur në mënyrë tjetër</u> | <u>Është parashkruar</u> | <u>Lëndë të zgjidhura</u> | <u>Lëndë të pazgjidhura</u> |
|------------------------------|----------------------|------------------------|-----------------------|-----------------------|----------------------------|------------------------------|----------------------------------------|--------------------------|---------------------------|-----------------------------|
| Gj. Themelore e Prishtinës   | 42                   | 1                      | 2                     | 3                     | 1                          | 3                            | -                                      | -                        | 10                        | 32                          |
| Dega Podujevë                | 1                    | -                      | -                     | -                     | -                          | -                            | -                                      | -                        | -                         | 1                           |
| Dega Glogoc                  | 1                    | -                      | -                     | -                     | -                          | -                            | 1                                      | -                        | 1                         | -                           |
| Gj. Themelore e Prizrenit    | 9                    | -                      | -                     | -                     | 1                          | -                            | 2                                      | -                        | 3                         | 6                           |
| Gjykata Themelore e Pejës    | 3                    | -                      | -                     | 1                     | -                          | -                            | -                                      | -                        | 1                         | 2                           |
| Gjykata Themelore e Gjilanit | 7                    | -                      | -                     | 1                     | -                          | -                            | 1                                      | -                        | 2                         | 5                           |
| Dega Kamenicë                | 2                    | -                      | -                     | -                     | -                          | -                            | -                                      | -                        | -                         | 2                           |
| Dega Viti                    | 4                    | -                      | -                     | -                     | -                          | -                            | -                                      | -                        | -                         | 4                           |
| Dega Novobërdë               | 1                    | -                      | -                     | -                     | -                          | -                            | -                                      | -                        | -                         | 1                           |
| Gj. Themelore Ferizaj        | 3                    | -                      | -                     | -                     | -                          | -                            | -                                      | -                        | -                         | 3                           |
| Dega Shtërpçë                | 2                    | -                      | -                     | -                     | -                          | -                            | -                                      | -                        | -                         | 2                           |
| Gj. Themelore e Gjakovës     | 4                    | -                      | 4                     | -                     | -                          | -                            | -                                      | -                        | 4                         | -                           |
| Dega Rahovec                 | 2                    | -                      | -                     | -                     | -                          | -                            | -                                      | -                        | -                         | 2                           |
| Gj. Themelore e Mitrovicës   | 110                  | -                      | -                     | -                     | 1                          | -                            | -                                      | 7                        | 8                         | 102                         |
| Dega Vushtrri                | 1                    | -                      | -                     | -                     | -                          | -                            | -                                      | -                        | -                         | 1                           |
| Dega Skenderaj               | 1                    | -                      | 1                     | -                     | -                          | -                            | -                                      | -                        | 1                         | -                           |
| <b>TOTALI</b>                | <b>193</b>           | <b>1</b>               | <b>7</b>              | <b>5</b>              | <b>2</b>                   | <b>4</b>                     | <b>4</b>                               | <b>7</b>                 | <b>30</b>                 | <b>163</b>                  |

Burimi: Këshilli Gjyqësor i Kosovës - KGJK

Nga të dhënat e shfaqura në tabelën e mësipërme kuptojmë se për vitin 2013-2014, janë gjithsej 193 lëndë që kanë qenë në punë në këto gjykata, ndërsa janë arritur të shqyrtohen dhe të gjykohen vetëm 30 prej tyre, apo 15 %. Kjo paraqet një përqindje mjaft të ultë të shqyrtimit dhe argumenton konstatimin tonë se shqyrtimi i ultë i lëndëve nga ana e gjyqësorit mund të jetë njëri nga faktorët pse mosdeklarimi i pasurisë ende vazhdon të jetë i lartë edhe përkundër penalizimit të saj.

Për më tepër, nga të gjitha vendimet e dhëna nga gjykatat, vetëm një vendim është me burgim në Gjykatën Themelore të Prishtinës, ndërsa 10 prej tyre kanë përfunduar me aktgjykim lirues, refuzues ose janë zgjidhur në mënyrë tjetër. Një e dhënë e rëndësishme për shqyrtim është edhe numri prej 7 lëndësh që janë parashkruar dhe atë në afat absolut në Gjykatën Themelore të Mitrovicës.

Nëse analizojmë këto të dhëna nga gjykatat mund të hasim në kontradikta të mëdha që nuk do të duhej të karakterizonin trajtimin e rasteve në fjalë. Për shembull, është e habitshme se si ka mundësi që 7 lëndë figurojnë të parashkruara në afatin absolut, ku afati i parashkrimit absolut është dyfishi i afatit relativ. Sipas Kodit Penal, afati më i shkurtër i parashkrimit të një veprë penale është 2 vite, dhe atë për parashkrimin relativ. Kjo nënkupton që veprat penale të dënueshme deri në një vit me burgim dhe ato të dënueshme me gjobë në aspektin relativ mund të parashkruhen pas dy viteve, ndërsa në aspektin absolut ato mund të parashkruhen pas katër vite. Vepra penale e mos raportimit ose raportimit të rremë të pasurisë është vepër e re penale, që nga 1 janari i vitit 2013, dhe është e pakuptimtë kalimi i 7 veprave të tilla penale në parashkrim absolut pa kaluar të paktën katër vite.

Kontradikta tjetër e theksuar që po ashtu sipas gjykimit tonë ka mundur të ndikojë në mos-uljen e numrit të mosdeklaruesve të pasurisë, por edhe e vazhdimin të deklarimit jo të plotë të pasurisë është edhe përmbajtja e natyrës së dënimit. Përderisa Kodi Penal, parasheh që për shkeljet e nenit 437 të shqiptohen vetëm dënime me burgim dhe me gjobë dhe kjo nënkupton që shqiptimet e dënimeve të tjera alternative apo zbatimit vetëm të dënimit me gjobë mund të paraqesin shkelje të këtij neni.

Në këtë tabelë ka edhe raste të dënimeve vetëm me gjobë, gjithsej 6, pastaj edhe dënime me kusht që janë 4 sosh. Shqiptimi i dënimeve me kusht dhe vetëm me gjobë është në kundërshtim me nenin 437 të Kodit Penal. Si pasojë e kësaj gjyqtarët që i kanë shqiptuar këto dënime, potencialisht mund të kenë kryer veprën penale të nxjerrjes së kundërligjshme të vendimeve gjyqësore të përcaktuara me nenin 432<sup>42</sup> të KPRK-së. Për më tepër, numri prej vetëm një të dënuari me burgim nga gjithsej 30 rastet e shqyrtuara për mosdeklarim apo deklarim të

<sup>42</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës - KPRK; Neni 432, Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore.

"Gjyqtari i cili me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër ose për t'i shkaktuar dëm personit tjetër, nxjerr vendim të kundërligjshëm, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet".

rrejshëm të pasurisë paraqet një masë inkurajuese për zyrtarët e lartë publik, të cilët, ngjashëm si në të kaluarën, përderisa kanë indikacione nga tradita e dënimeve të shqiptuara se mund të dalin pa dënim me burg, sërish preferojnë të mosdeklarojnë pasurinë për të cilën mund të mos kenë shpjegime racionale se si e kanë fituar.

Kjo bie ndesh edhe me Komentarin e KPRK-së. Sipas Komentarit të Kodit Penal të Kosovës, vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni “konsumohet, kur personi i cili, sipas ligjit për deklarim, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave të zyrtarëve të lartë publik, nuk e deklaron fare pasurinë e tillë, ose e deklaron pas skadimit të afatit ligjor për deklarim”.

“Veprën penale nga paragrafi 2, e konsumon zyrtari i cili, me rastin e deklarimit të pasurisë, falsifikon të dhënat ose nuk i paraqet të gjitha të dhënat e domosdoshme. D.m.th. me rastin e shkeljes së këtij paragrafi, vepra penale i ka dy forma alternative: alternativa e parë konsumohet kur kryesi falsifikon të dhënat (deklaron më pak sesa posedon pasuri realisht) dhe alternativa e dytë, kur kryesi nuk i jep të gjitha të dhënat e kërkuara nga ai, me qëllim të fshehjes së pasurisë, të cilën personi zyrtarë e ka realizuar në periudhën të cilën ka detyrim ta deklarojë atë”.

Profesori universitar dhe njëherit anëtar i komisionit hartues të KPRK-së, Haki Demolli, është i bindur se nëse një masë juridike është e shtruar në rrafshin “**dhe**” konkretisht “**dënim me gjobë dhe me burgim**” kjo nënkupton përfshihen të dyja masat juridike.<sup>43</sup>

Shqyrtimet gjyqësore të kësaj natyre, sidomos nëse kemi parasysh edhe aktvendimet e dënimeve alternative, përveç natyrës përmbajtësore të vendimeve të gjykatave, flasin edhe për një aspekt tjetër, atë të metodologjisë së punës së AKK-së, për të konstatuar shkeljet në procesin e deklarimit të pasurisë. Dënimet alternative të gjykatave mbase edhe mund të jenë të arsyeshme për shkak se ajo çfarë AKK-ja konstaton si shkelje të nenit 437 të KPRK-së, do të mund të prodhonte gjykime materialisht të paarsyeshme. Siç do të shihet në rastin e mëposhtem të deputetit të Kuvendit të Kosovës Nait Hasani, mosraportimi “pa dashje” i të hyrave nga honoraret nëpër komisione parlamentare, për gjykatën ka qenë i mjaftueshëm për ta liruar nga akuza, duke qenë se edhe honoraret ngjashëm si paga vjetore ka rrjedhur nga puna në Kuvend dhe s’ka pasur mundësi të fshihet e as të tjetërsohet. Si rrjedhojë, mund të ishte një trajtim i pabalancuar dhe i padrejtë në rast se deputeti Hasani, do të dënohej për shkak se nuk e ka përcaktuar në mënyrë të saktë shumën e të hyrave, duke mosdeklaruar vlerën prej 5,285 EUR, nga honoraret, duke e konsideruar si jorelevante deklarimin e tyre dhe pa dashje duke shkelur dispozitat ligjore, ndërsa të amnistojë një zyrtar tjetër që pasurinë e tij jashtë vendit e

---

<sup>43</sup> Qendra Kosovare për Gazetari Hulumtuese - Preportr; "M'rrojte, t'rrojta-brisku i Hasanit"; Besnik Boletini, Leonida Molliqaj, Prill, 2015; <http://preportr.com/sq/Re-publika/Mrrojte-trrojta-brisku-i-Hasanit-397>

deklaron vetëm në shifrat totale të vlerës së saj të hamendësuar duke aluduar se e njëjta i nënshtrohet ligjeve të vendeve ku gjindet dhe duke anashkaluar kështu legjislacionin vendas.

Parimisht, Ligji për Deklarim, është i qartë mbi atë se çka duhet të deklarohet, ndërsa Kodi Penal është po ashtu i qartë se kur dhe për çfarë mund të dënohet një person zyrtar për mosdeklarim apo deklarim të rrejshëm. Si rrjedhojë, vendimet e gjykatës për mosdeklarim apo deklarim të rrejshëm do të mund të ishin më të 'forta' për nga përmbajtja nëse puna e Agjencisë dhe faktet e prezantuara nga ajo përkitazi me deklarimin e rrejshëm të pasurisë nga zyrtarët e lartë publik do të ishin të bazuara në gjetje reale të shkeljeve përmbajtjesore të ligjit dhe të KPRK-së. Por kjo nuk ka ndodhur gjithmonë. Dy raste, që deri më tani publiku ka pasur qasje në natyrën e shkeljeve të pretenduara nga AKK të legjislacionit në fuqi, demonstrojnë më së miri metodologjinë e punës përmes së cilës AKK-ja konstaton se është bërë shkelje e nenit 437 për mosdeklarim apo deklarim të rrejshëm të pasurisë.

### **6.1 Rasti i Deputetëve Nait Hasani dhe Duda Balje të akuzuar për vepër penale sipas nenit 437 të Kodit Penal për Mosdeklarim apo Deklarim të rrejshëm të pasurisë.**

Rasti kundër Hasanit ishte iniciuar nga AKK-ja pas procesit të deklarimit të rregullt vjetor, ku pas hetimit të plotë AKK-ja kishte vërejtur se Hasani nuk e kishte deklaruar sakt pasurinë e tij në vitin 2012,<sup>44</sup> duke shkelur kështu provizionet e Nenit 437 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Sipas AKK-së, Hasani kishte deklaruar të hyrat vjetore prej 21,200 EUR nga paga në Kuvendin e Kosovës, mirëpo në listën e siguruar nga Kuvendi, AKK-ja kishte vërejtur shumën prej 26,485 EUR të cilat i ishin paguar atij.

Nga kjo pasqyrë, AKK-ja kishte konstatuar se Hasani nuk kishte deklaruar shumën prej 5,285 EUR, bazë kjo për të ngritur një akuzë për vepër penale. Gjatë shqyrtimit gjyqësor, Hasani ishte shprehur se ndjehej tërësisht i pafajshëm pasi që në parim, të gjitha të hyrat për të cilat ishte ngritur rasti vinin nga puna në Kuvendin e Kosovës, përfshirë edhe shtesat të cilat ai nuk i kishte deklaruar, dhe se të njëjtat nuk mund të konsiderohen si të fshehura apo të mosdeklaruar pasi që të njëjtat janë bartur nga Kuvendi në llogarinë personale të tij në bankë, i janë nënshtruar tatimit përkatës, dhe se i vetmi faj i paqëllimshëm i tij ishte mos njohuria se në regjistrin e deklarimit duhej deklaruar edhe shtesat nga puna në komisionet parlamentare, për të cilat ai do të mund të ishte ftuar për sqarim dhe përmirësim nga ana e AKK-së.<sup>45</sup>

Për më tepër, Hasani kishte ngritur këtë çështje në nivel të përgjithshëm, duke pretenduar se shumica e deputetëve të Kosovës bëjnë gabime të tilla, jo me shkas por si pasojë e mos

<sup>44</sup> Gazeta Jeta në Kosovë: "Nait Hasani Shpallet i Pafajshëm" Petrit Kryeziu, Janar, 2015. <http://gazetajnk.com/?cid=1,1018,9559>

<sup>45</sup> Po aty.



informimit të duhur dhe paqartësisë rreth plotësimit të formularit të deklaramit të pasurisë. Pas shqyrtimit, gjykata kishte vendosur ta shpallë të pafajshëm Hasanin, duke hedhur poshtë kështu argumentet e AKK-së për shkaktim të veprës penale.

Ky rast, na dëshmon se AKK-ja, nuk ka standarde të unifikuara përmes së cilave arrin në përfundime për shkaktimin e veprës penale për mosdeklarim apo deklarim të rrejshëm, por bënë interpretimin tekstual të ligjit, dhe se fillimisht nuk i kontakton zyrtarët për sqarime. Përkundër që AKK-ja ka pasur në dispozicion listën e pagesave totale nga ana e Kuvendit për deputetin Hasani, të cilat nuk mund të fshihen apo të tjetërsohen, ka ardhur në përfundim për shkelje të ligjit pa marrë në konsideratë shkaqet që kanë ndikuar tek ai për të mos deklaruar edhe pjesën e shtesave, dhe pa i dhënë rast për sqarim. Në rast se AKK-ja ka vepruar me këtë standard, atëherë nuk do të duhej të përjashtohet mundësia e dhjetëra rasteve të tjera të deputetëve të Kuvendit të Kosovës, të cilët në kolonën për deklarim të të hyrave vjetore kanë paraqitur vetëm vlerën e pagës mujore nga Kuvendi,<sup>46</sup> gjë që nuk nënkupton domosdoshmërisht se të njëjtit i kanë fshehur të ardhurat vjetore.

Rasti tjetër i freskët është ai i deputetës së Kuvendit të Kosovës, Duda Balje<sup>47</sup> e gjykuar për të njëjtat arsye, për mosdeklarim të plotë të pasurisë. Ngjashëm sikur tek deputeti Hasani, edhe tek znj. Balje, AKK-ja kishte konfirmuar mosdeklarimin e të hyrave nga puna në komisionet parlamentare që kapnin shifren prej 6,471.19 EUR. Koha e gjykimit të këtyre dy rasteve ishte shumë e afërt, dhe rasti i deputetit Hasani i gjykuar si i pafajshëm u përserit edhe tek deputetja Balje, duke qenë se i paraprinte një precedent i tillë.

Nga këto dy raste, pavarësisht se Çohu! nuk pretendon të vlerësojë vendimet e gjykatës përkatëse për rastet në fjalë, megjithatë në këto raste ka një mësim të rëndësishëm nga i cili duhet nxjerrë argumentin se gjykimet janë bërë mbi bazën e motiveve dhe jo mbi bazën e interpretimit nen për nen, apo tekstual të Kodit Penal të Kosovës. Mbi këtë bazë, Çohu! e ka parë me shqetësim iniciativën e Ministrisë së Drejtësisë (MD), për amandamentimin e Nenit 437 të KPRK-së, për të shtuar “motivin” e kryerjes së veprës penale për mosdeklarim apo deklarim të rrejshëm.<sup>48</sup> Pikërisht këto dy raste tregojnë se iniciativa e MD për amandamentim

---

<sup>46</sup> Disa nga formularët me karakteristika të tilla përfshijnë:

- Deputeti Afrim Hoti: [http://akk-ks.org/2014/Kuvendi\\_i\\_Republikes\\_se\\_Kosoves/Afrim\\_Hoti.pdf](http://akk-ks.org/2014/Kuvendi_i_Republikes_se_Kosoves/Afrim_Hoti.pdf)
- Deputetja Vesna Mikic: [http://akk-ks.org/2014/Kuvendi\\_i\\_Republikes\\_se\\_Kosoves/Vesna\\_Mikic.pdf](http://akk-ks.org/2014/Kuvendi_i_Republikes_se_Kosoves/Vesna_Mikic.pdf)
- Deputeti Xhevdet Neziraj: [http://akk-ks.org/2014/Kuvendi\\_i\\_Republikes\\_se\\_Kosoves/Xhevdet\\_Neziraj.pdf](http://akk-ks.org/2014/Kuvendi_i_Republikes_se_Kosoves/Xhevdet_Neziraj.pdf)
- ish Deputeti Skender Hyseni: [http://akk-ks.org/2014/Kuvendi\\_i\\_Republikes\\_se\\_Kosoves/Xhevdet\\_Neziraj.pdf](http://akk-ks.org/2014/Kuvendi_i_Republikes_se_Kosoves/Xhevdet_Neziraj.pdf)
- Deputeti Rustem Mustafa: [http://akk-ks.org/2014/Kuvendi\\_i\\_Republikes\\_se\\_Kosoves/Rustem\\_Mustafa.pdf](http://akk-ks.org/2014/Kuvendi_i_Republikes_se_Kosoves/Rustem_Mustafa.pdf)
- Deputetja Kimete Bytyqi: [http://akk-ks.org/2014/Kuvendi\\_i\\_Republikes\\_se\\_Kosoves/Kimete\\_Bytyqi.pdf](http://akk-ks.org/2014/Kuvendi_i_Republikes_se_Kosoves/Kimete_Bytyqi.pdf)
- Deputeti Haxhi Shala: [http://akk-ks.org/2014/Kuvendi\\_i\\_Republikes\\_se\\_Kosoves/Haxhi\\_Shala.pdf](http://akk-ks.org/2014/Kuvendi_i_Republikes_se_Kosoves/Haxhi_Shala.pdf)

<sup>47</sup> Kallxo.com: Deputetja Duda Balje në Gjykatë për mosdeklarim të pasurisë, Dhejtor, 2014; <http://live.kallxo.com/sq/MTL/Deputetja-Duda-Balje-Ne-Gjykate-Per-Mosdeklarim-Te-Pasurise-3611>

<sup>48</sup> Shih reagimin e organizatave të shoqërisë civile përkitazi me nenin 437 të KPRK. <http://www.cohu.org/sq/zyre-antikorrupsion-reagime/Reagim-kunder-ndryshimit-te-nenit-437-te-Kodit-Penal-nga-Ministria-e-Drejtësisë-167>

të Nenit 437 të KPRK-së, është e panevojshme duke qenë se gjykatat e kanë shumë të qartë çështjen e motivit kur është në pyetje aspekti i deklarimit të rrejshëm të pasurisë. Në fakt, Çohu! konsideron se amandamentimi i nenit 437 të KPRK, do të mund ta komplikonte edhe më shumë aspektin e vërtetimit të deklarimit të rrejshëm të pasurisë duke qenë se hipotetakisht të gjithë të akuzuarit që shkelin këtë nen do të mund aludonin në motive dhe arsye jo të qëllimta duke e zhvleftësuar edhe më shumë dispozitën në fjalë.

Problemet e konstatimit të AKK-së për shkeljet ligjore, sipas mendimit tonë duhet të adresohen në vazhden e standardizimit të praktikës së vlerësimit të pasurisë së deklaruar përmes instrumenteve dhe metodave të qarta të hetimit, dhe përderisa ekziston iniciativa e AKK-së për të paraqitur rastet për shkelje, ne konsiderojmë se kjo duhet parë me një qasje pozitive. Megjithatë, ajo çka mbetet shqetësuese dhe një nevojë urgjente për rishikim, është praktika dhe metodologjia e hetimit me të cilën Agjencia Kundër Korrupsionit vepron aktualisht e cila sipas analizës sonë karakterizohet me një mori problemesh e vakumesh esenciale pa të cilat veprimtaria e AKK-së është pothuajse irelevante. Këto vakume që ne i kemi identifikuar rrjedhin nga studimi analitik i praktikave ndërkombëtare krahasuar me atë vendore të DP-së dhe nga të gjeturat empirike të Çohu!, e të cilat janë shtruar më tutje në këtë analizë.

## 7. Procesi i deklarimit të pasurisë si kontribues për mosdeklarim

Parimisht, procesi i deklarimit të pasurisë do të duhej t'i shërbente agjendës së luftimit të korrupsionit politik përmes realizimit të instrumentit të transparencës dhe mbikqyrjes së pasurisë së zyrtarëve të lartë publik. Çdo agjens i kësaj fushe teorikisht do të duhej të ishte kontributdhënës në realizimin kuptimplotë të këtij procesi, përfshirë edhe deklarimin e plotë të pasurisë së zyrtarëve të lartë publik. Megjithatë, në rastin e Kosovës, sipas këndveshtrimit tonë, disa nga arsyejet që kanë kontribuar në vazhdimin e trendit të mos-deklarimit të pasurisë dhe deklarimit të rrejshëm të saj janë analizuar dhe paraqitur më poshtë.

- a) **Vendimet “e buta” të gjykatave:** Përgjithësisht siç u konstatua edhe më lart, një nga shkaqet që potencialisht kanë nxitur numrin e madh të zyrtarëve që nuk e deklarojnë pasurinë - posaçërisht ata zyrtarë deri para penalizimit të kësaj veprë - dhe sidomos ata që deklarojnë rrejshëm pasurinë, janë vendimet e buta të gjykatave të cilat nuk reflektojnë seriozitetin e duhur për të marrë masa kundër kësaj dukurie;
- b) **Trendi i ultë i shqyrtimit të lëndëve kundër korrupsionit:** Statistikat për rastet e trajtuara të korrupsionit nga prokuroritë dhe gjykatat përkitazi me nenin 437 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), tregojnë për një trend të ulët të shqyrtimit dhe për shumë edhe për një natyrë kontraverse të shqyrtimit të rasteve që kanë të bëjnë me korrupsion, siç është parashkrimi i veprave të ndërlidhura me nenin 437 të Kodit Penal të Kosovës. Ky trend i ulët mund të ketë inkurajuar zyrtarët e lartë publik që procesin e deklarimit të pasurisë mos ta perceptojnë si një shkelje ngjashëm me shkeljet tjera që paraqesin vepra penale sipas Kodit Penal të Kosovës; *(Gjatë viteve 2013-2014, në punë kanë qenë gjithsej 193 lëndë që i përkasin nenin 437 të KPRK-së, prej të cilave janë shqyrtuar dhe gjykuar vetëm 30 prej tyre, apo 15 % e shprehur në përqindje).*
- c) **Pamundësia e verifikimit të saktësisë së pasurisë:** Përderisa legjislacioni në fuqi dhe mandati i AKK-së, veçanërisht metodologjia e punës së saj, karakterizohen me jo-konsistencë, paqartësi dhe mungesë të specifikimit të instrumenteve për verifikim të: **a)** saktësisë së pasurisë, **b)** kontrollim të origjinës së saj, **c)** verifikimin e pasurisë jashtë vendit, **d)** mos analizimi aritmetik i i relacionit në mes të të hyrave të zyrtarit dhe pasurive të tij, mund të kenë ndikuar drejtpërdrejtë që një numër i zyrtarëve publik të stimulohen për të mos deklaruar në tërësi apo pjesërisht asetet e tyre;
- d) **(Mos)Funksionimi i Pikave të Kontaktit apo mos informimi i mirëfilltë:** Në shumë raste të ngritura nga AKK-ja për mosdeklarim, përfshirë edhe 71 zyrtarë që nuk kanë

deklaruar pasurinë për vitin 2015,<sup>49</sup> Çohu! ka gjetur që 33 prej tyre kanë pasur për obligim deklarin e pasurisë për herë të parë, pra zyrtarë publik që për herë të parë marrin një funksion publik. Në këtë kuadër, dështimi për ta deklaruar pasurinë nga këta 33 zyrtarë të lartë publik duhet të lidhet më shumë me mosfunksionim adekuat të pikave të kontaktit brenda institucioneve përkitazi me njoftimin e tyre rreth obligimeve ligjore për deklarin të pasurisë.

- e) **Mënyra e konstatimit të veprës penale “Deklarim i rrejshëm i pasurisë” nga AKK-ja.** Në parim duket e habitshme, por edhe mënyra se si AKK-ja konstaton “shkeljen”, e ligjit për deklarin të pasurisë, përkatësisht rreth deklarin të rrejshëm të saj, paraqet edhe një arsye, që përgjithësisht do të mund të ketë kontribuar në mosdeklarin dhe deklarin jo të plotë të pasurisë. Siç e pamë më lartë në dy rastet e trajtuara të dy deputetëve që kanë qenë subjekt i gjykimit për një akuzë të tillë, mund të kuptojmë se AKK-ja nuk ka një metodë të standardizuar dhe se përpjekja për të konstatuar veprën penale të deklarin të rrejshëm të pasurisë pa një përpjekje fillestare për të evituar gabimet e mundshme, paraqet mungesën e besimit në qëllimin pozitiv të kësaj Agjencie, dhe si rrjedhojë edhe mospërfilljen e saj.

---

<sup>49</sup> AKK, Lista e Zyrtarëve që nuk e kanë deklaruar pasurinë në afatin e rregullt vjetor për vitin 2015: [http://akk-ks.org/repository/docs/Lista\\_mos\\_deklarimi\\_2015\\_.pdf](http://akk-ks.org/repository/docs/Lista_mos_deklarimi_2015_.pdf)

## 8. Vlefshmëria e të dhënave: Segmentet problematike

---

Një nga aspektet që ofron një pasqyrë më të qartë të tërë procesit të DP-së dhe problemeve që ne i kemi identifikuar si esenciale dhe të nevojshme për t'u hedhur në shqyrtim është edhe vlefshmëria e të dhënave të disponuara nga AKK-ja, apo krahasimi dhe verifikimi i të dhënave përmes llogaritjes aritmetike, realitetit ekzistues dhe stilit të jetës së zyrtarëve të lartë publik. Në fakt, vlefshmëria e të dhënave paraqet një aspekt thelbësor pa të cilin i tërë procesi i DP-së, nuk do të kishte kuptim. Nisur nga kjo ne kemi hulumtuar praktikën dhe metodologjinë e verifikimit që aplikon AKK-ja për të siguruar vlefshmërinë ose jo të të dhënave, me ç'rast kemi parë që në rastin e Kosovës, vlefshmëria e të dhënave të deklaruara mbetet një nga problemet dhe debatet më të mëdha. Kjo ndodhë për shumë arsye, ku ndër më kryesoret kanë të bëjnë me:

- a) Mungesën e qartësisë së mandatit verifikues të AKK-së;
- b) Dis'harmonisë në mes ligjeve themelore kundër korrupsionit me ligje të tjera relevante dhe me Kodin e Procedurës Penale;
- c) Mungesën e instrumenteve dhe metodave të hetimit të plotë si mekanizëm për të verifikuar saktësinë e të dhënave;

Për mendimin tonë, mungesa e një mandati të qartë të Agjencisë për të ushtruar verifikim të plotë të pasurive të deklaruara nga zyrtarët e lartë publik paraqet një nga vakumet më të mëdha në këtë drejtim. Mbi premisat e lartëpërmendura, Çohu!, ka hulumtuar aspektet legislative si dhe praktikën e zbatimit që lidhen me mandatin e AKK-së dhe kemi demonstruar edhe me shembuj konkret studimi problemet e kësaj natyre. Nisur nga praktika aktuale dhe bazuar në Ligjin për Agjencinë Kundër Korrupsionit, dhe Ligjin për Deklarim të Pasurisë (përfshirë amandamentet), AKK-ja realizon dy lloje të kontrolleve:

- a) **Kontrolli Paraprak**, i cili nënkupton kontrollin preliminar të formularëve në mënyrë që të identifikohen të ashtuquajturat “gabime materiale/teknike”, për të cilat zyrtari publik ka në dispozicion një afat ligjor prej 15 ditësh që t'i përmirësojë ato, dhe i cili hetim është i natyrës administrative pa u lëshuar në detaje dhe analiza përkatëse të formularëve; si dhe
- b) **Kontrolli i Plotë**, i cili paraqet një kontroll më të detajshëm nga ana e AKK-së, kryesisht bazuar në metodologjinë e “krahasimit të përputhshmërisë”, së të dhënave të deklaruara me institucionet tjera publike;

Nga praktika bashkëkohore ekzistojnë tre modele të kontrollit të pasurisë së zyrtarëve të lartë publik. Në radhë të parë është Kontrolli Themelor (Basic Verification)<sup>50</sup> i cili paraqet kontrollin për probleme materiale ngjashëm me atë që e aplikon AKK-ja me rastin e Kontrollit Preliminar. Kontrolli i Thjeshtë (Simple Verification)<sup>51</sup> që korrespondon me Kontrollin e Plotë të AKK-së, shkon më tutje në vetë përmbajtjen e të dhënave të deklaruara, përkatësisht në llogaritjen aritmetike të përputhshmërisë së të dhënave të deklaruara me realitetin ekzistues. Në këtë kuadër, AKK-ja përmes kontrollit të plotë nuk arrin të hetojë në tërësi pasurinë e zyrtarëve të lartë publik për shkak se nuk ka autorizime për qasje në banka siç e kemi shpjeguar më lartë, apo në pasuritë jashtë vendit.

Metoda tjetër është ajo e Auditimit (Audit Verification)<sup>52</sup> në të cilën AKK-ja nuk ka funksione korresponduese si pasojë e mandatit të saj të mangët, për dallim nga Shqipëria p.sh, e cila përmes Inspektoratit të Lartë për Deklarimin dhe Auditimin e Pasurisë<sup>53</sup> kryen edhe auditimin e plotë të pasurisë përfshirë jo vetëm konstatimin e gjendjes ekzistuese por edhe origjinës së saj. Për ne është me interes të analizojmë vetëm atë pjesë të fushëveprimit të AKK-së për të cilat ka mandat ligjor, duke e sjellë kështu në fokus metodën e Kontrollit të Plotë dhe problemet që e shoqërojnë atë. Përgjithësisht, AKK-ja nuk ka bërë asnjëherë apo të paktën nuk ka publikuar ndonjë analizë që ka për bazë llogaritjen aritmetike në bazë të së cilës do të vinte në përfundim se pasuria e deklaruar e zyrtarëve të lartë nuk është e saktë në realitet.

Kontrolli i plotë fillon pas përzgjedhjes së zakonshme të një numri prej 20% të formularëve për çdo vit, me ç'rast AKK-ja përpilon të dhënat e formularëve të zyrtarëve të përzgjedhur për kontroll të plotë dhe këto të dhëna i krahason me institucionet tjera publike siç janë Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve, Agjencia Kadastrale e Kosovës, Administrata Tatimore, Ministria e Financave etj.<sup>54</sup> Në rast se AKK-ja konstaton se ka mospërputhje të të dhënave të deklaruara të pasurisë me të dhënat e siguruar nga institucionet tjera, atëherë AKK-ja mund të ngrisë kallëzim penal për deklarim të rrejshëm të pasurisë. Mirëpo, në gjykimin tonë, kontrolli i plotë ndonëse paraqet shkallën më të gjerë të kompetencave të AKK-së, krahasuar me praktikën dhe modelet bashkëkohore të vendeve të ndryshme, është i përgjysmuar dhe i paefektshëm për disa arsye të cilat i kemi shtruar më tutje:

<sup>50</sup> Organization for Economic Co-operation and Development- OECD, "Asset Declarations for Public Officials - A Tool to Prevent Corruption"; fq. 73; 2011. <http://www.oecd.org/corruption/anti-bribery/47489446.pdf>

<sup>51</sup> Po aty, fq. 73;

<sup>52</sup> Po aty, fq. 73;

<sup>53</sup> Ligji për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive, të Detyrimeve Financiare të të Zgjedhurve dhe të disa Nëpunësve Publik: <http://www.hidaa.gov.al/ligji-nr/>;

<sup>54</sup> AKK (2015) Udhezues praktik nga fusha e parandalimit të korrupsionit: [http://www.akk-ks.org/repository/docs/udhezimi%20shqip%20finale%20\(4\).pdf](http://www.akk-ks.org/repository/docs/udhezimi%20shqip%20finale%20(4).pdf)

## 8.1 Mungesa e Qasjes në Banka dhe Institucione Financiare

Në parim, në mënyrë që verifikimi i vlefshmërisë së të dhënave të deklaruara të jetë i plotë, AKK do të duhej të kishte në dispozicion mjete të plota të hetimit dhe veçanërisht qasjen në llogaritë bankare të zyrtarëve të lartë publik, në mënyrë që të analizojë transaksionet bankare, origjinën dhe historikun e tyre. Në këtë aspekt, ka një mospërputhje të kuadrit ligjor që hapur bie në kontradiktë të plotë. Në Ligjin për Deklarim të Pasurisë një gjë e tillë bëhet e mundur pasi që nënen 16, paragrafi 3,<sup>55</sup> thotë që “Me kërkesë të Agjencisë, Bankat dhe subjektet e tjera, që ushtrojnë veprimtari bankare dhe financiare në Kosovë, detyrohen të japin të dhëna për depozitat, llogaritë dhe transaksionet e kryera nga personat që sipas këtij ligji, kanë detyrimin për deklarim” ndërsa pas amandamentimit të ligjit, paragrafit të njëjtë i është shtuar edhe: “në përputhje me Kodin e Procedurës Penale.”<sup>56</sup>

Në anën tjetër, Kodi i Procedurës Penale në nenin 86, paragrafi 2, thotë që për hetimin me masa të fshehta duhet të ekzistojë një autorizim i gjykatësit të procedurës paraprake,<sup>57</sup> përderisa neni 87 e futë zbulimin e të dhënave financiare në kategorinë e masave të fshehta.<sup>58</sup> Siç mund të shihet, dispozitat ligjore janë në kontradiktë të plotë me Kodin e Procedurës Penale, me ç'rast kuptohet që Agjencia në mënyrë të drejtpërdrejtë nuk mund të ketë qasje në llogaritë bankare të zyrtarëve të lartë publik. Në fakt, Agjencia është përpjekur shpesh që të pretendojë qasjen në llogaritë bankare përmes bashkëpunimit me Njësinë e Inteligjencës Financiare (NIF), por edhe këtu ka një mospërputhje të plotë nga aspekti ligjor. Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parasë dhe Financimit të Terrorizmit, ka paraparë që i vetmi institucion me qasje të drejtpërdrejtë në llogaritë bankare është NIF. Në nenin 15 të këtij ligji, përshkruhet natyra e informacionit që NIF mund të ofrojë për institucionet tjera, ndërsa paragrafi i dytë në mënyrë eksplicite emërton institucionet me të cilat NIF mund të ndajë informata, në listën e së cilave nuk bën pjesë edhe AKK.<sup>59</sup> Nga kjo perspektivë mund të kuptojmë se AKK nuk ka qasje në llogaritë bankare dhe si rezultat, nuk e ka në dispozicion një nga instrumentet më të rëndësishme të verifikimit të të dhënave të deklaruara të zyrtarëve të lartë publik

<sup>55</sup> Ligji Nr. 04/L-050: Për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar, Neni 16, paragrafi 3;

<sup>56</sup> Ligji Nr. 04/L-228: Për Amandamentimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-050: Për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar, neni 10;

<sup>57</sup> Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, Neni 86, Paragrafi 1 dhe 2;

<sup>58</sup> Po aty, Neni 87, Paragrafi 1.12;

<sup>59</sup> Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parasës dhe Financimit të Terrorizmit, Neni 15, paragrafi 2;

## 8.2 Mungesa e Standardeve për Konstatim të Vlerës së Deklaruar:

AKK-ja nuk ka në dispozicion asnjë mekanizëm për të vlerësuar përmbajtjen apo vlerën reale të pasurisë së deklaruar nga ana e zyrtarëve të lartë publik. Me fjalë të tjera, AKK nuk mund të dijë nëse vlera e deklaruar sipas hamendësimit të zyrtarëve të lartë publik në fakt paraqet vlerën reale të tregut të aseteve në fjalë. Një shembull për të demonstruar këtë, është deklarimi i anëtarit të Kuvendit Komunal të Prishtinës Visar Arifaj, i cili në formularin e deklarimit të pasurisë me rastin e marrjes së detyrës zyrtare, në kolonën për deklarimin e pasurisë së paluajtshme, ka deklaruar një pikturë, krijim personal të zyrtarit i bërë në vitin 1995, vlerën e të cilës e ka konstatuar të jetë një miliard EUR.<sup>60</sup>

## 8.3 Mungesa e Standardizimit të Përmbajtjes së Emërtimeve dhe Nocioneve të Pasurisë:

AKK nuk ka ndonjë standard në bazë të së cilit do të përcaktohej aspekti i emërtimeve të saktë dhe të njëkuptimshëm të aseteve të deklaruar. Në shumë raste emërtimet që në sens kanë përmbajtje të njëjtë jepen në emra të ndryshëm, dhe që për nga aspekti përmbajtjesor dallojnë në vlerën e tregut të këtyre aseteve. Për shembull, në shumë formularë përdorën emërtime si arë, tokë, fushë, tokë pune, truall, parcelë, mal etj, të cilat për nga vlera paraqiten të njëjta ndërsa në realitet është i ditur fakti se një truall është shumë herë më i shtrenjtë sesa një mal apo se çfarë paraqet një “tokë” përderisa nuk ka një mbiemër të identifikueshëm nëse bëhet fjalë për tokë pune, mal, arë apo livadh.

## 8.4 Mungesa e Deklarimit të Detajuar të Aseteve mbi vlerën 3,000 Euro:

Në shumë raste, deklarimi i aseteve mbi vlerën e përcaktuar me ligj prej 3,000 EUR, po ashtu paraqet një pengesë për AKK-në për të vlerësuar vlefshmërinë e të dhënave të paraqitura. Për shembull, në shumë regjistra, paraqiten deklarimet për automjetet private në emërtimin e abstraktuar: **veturë, automjet, makinë**, të cilat shoqërohen me vlerën e tyre anash. Për mendimin tonë është vështirë të identifikohet vlera e tyre përderisa nuk janë të paraqitura me saktësi të gjitha të dhënat përcjellëse. Kjo për faktin se veturë, makinë apo automjet mund të jetë edhe një automjet i vitit 1990, vlera e të cilit në treg të jetë tejet e ultë, po aq sa mund të jetë një automjet i vitit 2012 vlera e të cilit natyrisht se është më e lartë. Si rrjedhojë, kjo mungesë e standardizimit të ofrimit të të dhënave të detajshme siç janë për shembull, të dhënat për markën prodhuese të automjetit, mbi vitin e prodhimit të

---

<sup>60</sup> AKK, Deklarimi i Pasurisë 2014: [http://akk-ks.org/2014/Komunat/Komuna\\_e\\_Prishtines/Visar\\_Arifaj.pdf](http://akk-ks.org/2014/Komunat/Komuna_e_Prishtines/Visar_Arifaj.pdf)



automjetit dhe të dhëna të tjera që japin indikacione mbi të cilat mund të ndërtohet një gjykim racional i vlerës së asetit në fjalë.

## 8.5 Mos'harmonizimi dhe mos sistemimi i regjistrave të pasurisë (të metat materiale dhe teknike).

Në aspektin e të metave teknike dhe materiale, nëse analizohen regjistrat e pasurisë dhe duke pasur parasysh mungesat e specifikuar më lartë, duhet theksuar se përveç kontrollit të plotë që nuk ka mundësi të realizohet për arsyet e shtruar në kapitullin vijues, lehtë mund të konstatohet se edhe kontrolli paraprak ka mangësi të mëdha që e bejnë pothuajse irelevante deklarin e pasurisë. Me theks të veçantë, problemet dalin tek mënyra se si plotësohen formularët dhe se çfarë përfundimesh mund të nxirren nga një plotësim i tillë. Konkretisht, në shumë raste të plotësimit të formularëve janë vërejtur probleme të tilla si:

- ***Paqartësitë në vlerat debitore të kredive.*** Në rastet kur zyrtarët e lartë publik deklarojnë kreditë e tyre bankare dhe borxhin që e kanë në këto banka, ata e deklarojnë vetëm vitin e marrjes së kredisë, të përfundimit dhe shumën e kredisë. Por në deklarin e mëtejme vjetore nuk e zbresin vlerën kumulative të borxhit të mbetur.<sup>61</sup> Kjo formë e plotësimit të regjistrave të pasurisë madje është e udhëzuar edhe me Udhëzuesin Praktik nga Fusha e Parandalimit dhe Luftimit të Korrupsionit, i cili është përpiluar në mars 2015.<sup>62</sup> Duhet theksuar se kjo formë e plotësimit të regjistrave të pasurisë përkitazi me vlerat debitore të kredive pamundëson një vlerësues të jashtëm, përfshirë edhe vetë AKK-në që të identifikojë vlerën e borxhit të mbetur të zyrtarit të lartë publik; dhe rrjedhimisht të ushtrojë monitorim të plotë të pasurisë së zyrtarëve publik. Madje në këtë kuadër, ka raste të atilla që në regjistrat e pasurisë, zyrtari vendosë vetëm shumën dhe vitin kur kredia është marrë pa ofruar asnjë të dhënë tjetër, dhe e njëjta është pranuar nga AKK-ja.<sup>63</sup>
- ***Mungesa e të dhënave për vitin e përfitimit të pasurisë.*** Në shumë raste vërehet mosplotësimi i të dhënave për vitin e përfitimit të pasurisë apo karakteristikat tjera që lidhen me natyrën, llojin dhe përmbajtjen e pasurisë. Bie fjala, deklarimi i posedimit të një prone të paluajtshme pa një datë se kur është përfituar dhe pa një përshkrim të karakteristikave të saj që do të përbënin indikacion mbi vlerën aktuale në treg, poashtu pamundëson vlerësimin e jashtëm të saktësisë së të dhënave të deklaruara. Kjo duke qenë se në ato raste kur nuk dihet data e përfitimit të një prone të caktuar nuk mund të

---

<sup>61</sup> Regjistri i Pasurisë i drejtorit të AKK-së, Hasan Preteni. [http://akk-ks.org/2014/Agjencite\\_e\\_Pavarura/Agjencia\\_kunder\\_Korrupsionit/Hasan\\_Preteni.pdf](http://akk-ks.org/2014/Agjencite_e_Pavarura/Agjencia_kunder_Korrupsionit/Hasan_Preteni.pdf)

<sup>62</sup> Agjencia Kundër Korrupsionit; Udhësues Praktik nga Fusha e Parandalimit dhe Luftimit të Korrupsionit, Mars, 2015. [http://akk-ks.org/repository/docs/udhezimi%20shqip%20finale%20\(4\).pdf](http://akk-ks.org/repository/docs/udhezimi%20shqip%20finale%20(4).pdf)

<sup>63</sup> Regjistri i pasurisë i ish kryeministrit të Kosovës, Hashim Thaqi. [http://akk-ks.org/2014/Qeveria/Zyra\\_e\\_Kryeministrit\\_te\\_Republikes\\_se\\_Kosoves/Hashim\\_Thaci.pdf](http://akk-ks.org/2014/Qeveria/Zyra_e_Kryeministrit_te_Republikes_se_Kosoves/Hashim_Thaci.pdf)

bëhet asnjë analizë rreth relacionit në mes të hyrave të zyrtarit të caktuar dhe përfitimit të një prone.<sup>64</sup>

- *Mungesa e të dhënave rreth origjinës së pronësisë.* Në disa raste, sidomos të nxjerrura edhe nga hulumtimi empirik figuron një mungesë e të dhënave mbi origjinën e pasurisë. Në këtë rrafsh, një zyrtar i caktuar publik, deklaron si të tij një pronë të caktuar por nuk deklaron, ashtu siç specifikohet me regjistrat e pasurisë edhe origjinën e saj. Në rastin e deputetës Teuta Sahatqija si shembull, në kolonën e deklarimit të pasurisë së paluajtshme, një shtëpi, një banesë dhe një arë deklarohen si pasuri e ose në emër të bashkëshortit ose si të përbashkët,<sup>65</sup> por nuk specifikon prejardhjen (origjinën e pasurisë), element ky që poashtu paraqet një problem për vlerësim të jashtëm.

Këto aspekte që lidhen me mungesën e njësimi të regjistrave të pasurisë e bëjnë të vështirë monitorimin e procesit të deklarimit të pasurisë nga ana e shoqërisë civile dhe gjithashtu e pengojnë punën profesionale të AKK-së. Në rrethana të tilla pra, përderisa një zyrtar e vendosë shumën e kredisë dhe e vendosë datën e marrjes dhe datën e përfundimit të kredisë por shumën nuk e zbret mbi bazën e kthimit të borxhit, paraqet një pengesë reale për të bërë verifikim të pavarur.

Me të gjitha këto segmente problematike, pavarësisht se pretendohet që bëhet kontrolli i plotë, AKK-ja e ka të vështirë të konstatojë nëse vlerat e deklaruara në fakt paraqesin të dhëna të besueshme dhe të vërteta që do t'i japin kuptim procesit të deklarimit të pasurisë. Përfunduar këto aspekte të lartpërmendura, gjatë shqyrtimit të premisave të kësaj teme, ne kemi vërejtur edhe disa mangësi të tjera themelore që janë akoma më fundamentale dhe që e paraqesin punën e Agjencisë Kundër Korrupsionit, si jo-relevante. Këto mangësi kanë të bëjnë me dy nga aspektet themelore të vlefshmërisë së të dhënave: a) origjina e pasurisë dhe b) saktësia e të dhënave, për të cilat do flasim ndaras dhe do ofrojmë shembuj konkret.

<sup>64</sup> Qendra Kosovare për Gazetari Hulumtuese - Preportr; "M'rrojte, t'rrojta-brisku i Hasanit"; Besnik Boletini, Leonida Molliqaj, Prill, 2015; <http://preportr.com/sq/Re-publika/Mrrojte-trrojta-brisku-i-Hasanit-397>

<sup>65</sup> AKK: Deklarimi i pasurisë 2013 dhe 2014 nga deputetja Teuta Sahatqija: [http://akk-ks.org/2013/Kuvendi/Teuta\\_Sahatqija.pdf](http://akk-ks.org/2013/Kuvendi/Teuta_Sahatqija.pdf); [http://akk-ks.org/2014/Kuvendi\\_i\\_Republikes\\_se\\_Kosoves/Teuta\\_Sahatqija.pdf](http://akk-ks.org/2014/Kuvendi_i_Republikes_se_Kosoves/Teuta_Sahatqija.pdf)

## 9. Verifikimi i Origjinës së Pasurisë dhe Pasurisë Jashtë Vendit të Zyrtarëve të Lartë Publik

---

Me origjinë të pasurisë së zyrtarëve të lartë publik sipas detyrimeve ligjore dhe praktikës bashkëkohore kuptojmë ofrimin e informatave që kanë të bëjnë me një aset të caktuar për të cilin zyrtari i lartë publik ofron të dhëna si vijon:

- 1) Vendin dhe kohën e pasurisë së fituar;
- 2) Dëshmitë për transaksionet e shkëmbimit përmes së cilës zyrtari i lartë publik ka përfituar pasurinë në fjalë; dhe
- 3) Historinë e përfitimit të të mirave nga pasuria në fjalë, përmes së cilës zyrtari i lartë publik ka mundur të shtojë asete të tjera;

Në këtë kuadër, Agjencia Kundër Korrupsionit, përmes formularëve të deklarimit të pasurisë si dhe përmes masave të kontrollit paraprak dhe kontrollit të plotë, bazuar në ligjin bazik, do të duhej të bënte edhe verifikimin e origjinës së pasurisë. Megjithatë, përderisa u konstatua më lartë se AKK nuk ka qasje në llogaritë bankare, në mënyrë të drejtpërdrejtë shtrohet pyetja se me çfarë instrumenti AKK e verifikon origjinën e pasurisë. Parimisht, në formularin e deklarimit të pasurisë kërkohet që të përshkruhen asetet dhe të përshkruhet koha dhe vendi i përfitimit. Megjithatë në mungesë të instrumenteve të verifikimit ka raste kur zyrtarët e lartë publik mund të japin përgjigje të pakompletuara apo jo-relevante për të cilat AKK nuk ka mundësi se si t'i hetojë. Për më tepër, vetë Ligji për Deklarimin, Origjinën dhe Kontrollin e Pasurisë, në emërtimin e tij parasheh “origjinën” e pasurisë si një kategori në vete, por në praktikë nuk është dhënë asnjë atribut Agjencisë Kundër Korrupsionit, përmes së cilit ajo do të mund të realizonte këtë kategori ligjore. Konstatimi i përgjithshëm në këtë rrafsh është se AKK-nuk ka në dispozicion asnjë mekanizëm për verifikimin e origjinës së pasurisë dhe si e tillë, kjo kategori është tërësisht jorelevante në punën e AKK-së kundër korrupsionit dhe në zbatimin e ligjit.

Paralelisht me mungesën e instrumenteve për verifikimin e origjinës së pasurisë, “kriza” në këtë aspekt bëhet edhe më kuptimplote kur kemi parasysh verifikimin e pasurisë jashtë vendit. Rasti më flagrant për mendimin tonë që demonstroi saktësisht argumentin e paaftësisë së AKK-së për të verifikuar origjinën e aseteve jashtë vendit është rasti i ish zëvendëskryeministrit të Kosovës, Behgjet Pacolli, i shtruar më tutje:

### 9.1 Rasti i Behgjet Pacolli- pamundësia e verifikimit të pasurive jashtë vendit

Në vitin 2011, Pacolli në regjistrin e deklarimit të pasurisë, kishte deklaruar kompani me asete anonime jashtë Kosovës në vlerë prej 80 milionë EUR<sup>66</sup> Pacolli iu referohet këtyre kompanive si kompani (në shumës) që veprojnë jashtë Kosovës dhe që u nënshtrohen ligjeve përkatëse të vendeve ku operojnë. Mbi këtë bazë, Pacolli nuk ka dhënë informacion dhe as i është kërkuar nga AKK që të japë informacion për detyrimet ligjore si vijon:

- a) Emrin e kompanive,
- b) Vendin ku operojnë;
- c) Aktivitetet ekonomike me të cilat merren;
- d) Datën e themelimit të tyre; apo ndonjë informacion tjetër të vlefshëm që arsyeton origjinën e pasurisë prej 80 milionë EUR.

Ngjashëm vepron Pacolli në vitin 2012, kur ofron të njëjtin përshkrim përjashtuar vlerën, e cila tashmë është 95 milionë. EUR.<sup>67</sup> Paaftësia dhe neglizhenca e AKK-së me këtë rast dëshmohej për faktin se nëse kjo shkelje është bërë në vitin 2011, atëherë do të duhej t'i ishte tërhequr vërejtja personit zyrtar, gjë që nuk është bërë, pasi që jo vetëm në vitin 2012, por edhe vitin 2013 dhe së fundmi me rastin e deklarimit të pasurisë pas përfundimit të detyrës zyrtare në vitin 2014 Pacolli ka deklaruar pasurinë në mënyrën e njëjtë. Ky rregull përjashtues të cilin AKK-ja e ka toleruar me rastin e Pacollit në procesin e deklarimit nuk ka qenë i njëjtë edhe për zyrtarë të tjerë për të cilët kanë pasuri jashtë vendit siç është rasti me ish deputetin e Kosovës, Florin Krasniqi i cili në regjistrin e deklarimit të pasurisë ka ofruar të dhëna të plota për emrin, vitin e përfitimit dhe vendin e operimit të kompanive që i kishte nën pronësi.<sup>68</sup>

Në rastin e Pacollit, po ashtu të gjitha paratë e mbajtura në bankat e Kosovës janë deklaruar si para të fituara jashtë vendit, pa dhënë asnjë arsyetim mbi origjinën e fitimit të tyre, apo mbi bazën e çfarë aktiviteti ekonomik janë përfituar ato. E vetmja gjë që mund të llogaritet e deklaruar është vlera e aksioneve e cila brenda tre periudhash vjetore të deklarimit pra 2011, 2012 dhe 2013, ka shënuar ngritje të konsiderueshme. Kështu në vitin 2013, Pacolli deklaroi kompanitë anonime me vlerën e aksioneve prej 125 milionë EUR.<sup>69</sup>

Nëse i kthehemi vlerësimit të mandatit dhe kompetencave të AKK-së, përmes këtij rasti mund të kuptojmë se AKK për asnjë moment të vetëm nuk ka mundur të kuptojë se për cilat kompani

---

<sup>66</sup>AKK: Deklarimi i Pasurisë, Behgjet Pacolli, 2011; [http://akk-ks.org/2011/Qeveria\\_e\\_Republikes\\_se\\_Kosoves/Zyra\\_e\\_Kryeministrit\\_te\\_Republikes\\_se\\_Kosoves/Behgjet\\_Pacolli.pdf](http://akk-ks.org/2011/Qeveria_e_Republikes_se_Kosoves/Zyra_e_Kryeministrit_te_Republikes_se_Kosoves/Behgjet_Pacolli.pdf)

<sup>67</sup>AKK: Deklarimi i Pasurisë, Behgjet Pacolli, 2012; [http://akk-ks.org/2012/Qeveria/Zyra\\_e\\_Kryeministrit\\_te\\_Republikes\\_se\\_Kosoves/Behgjet\\_Pacolli.pdf](http://akk-ks.org/2012/Qeveria/Zyra_e_Kryeministrit_te_Republikes_se_Kosoves/Behgjet_Pacolli.pdf)

<sup>68</sup>AKK: Deklarimi i Pasurisë, Florin Krasniqi, 2011; [http://ACA-ks.org/2011/Kuvendi\\_i\\_Republikes\\_se\\_Kosoves/Florin\\_Krasniqi.pdf](http://ACA-ks.org/2011/Kuvendi_i_Republikes_se_Kosoves/Florin_Krasniqi.pdf)

<sup>69</sup>AKK: Deklarimi i Pasurisë, Behgjet Pacolli, 2013; [http://ACA-ks.org/2013/qeveria/Zyra\\_e\\_Kryeministrit\\_te\\_Republikes\\_se\\_Kosoves/Behgjet\\_Pacolli.pdf](http://ACA-ks.org/2013/qeveria/Zyra_e_Kryeministrit_te_Republikes_se_Kosoves/Behgjet_Pacolli.pdf)

anonime bëhet fjalë, si dhe mbi bazën e çfarë aktiviteti ekonomik ka shënuar rritje pasuria e deklaruar ndër vite e zyrtarit në fjalë. Mbi këtë bazë është shkelur neni 13 i Ligjit për Deklarim të Pasurisë, i cili shprehimisht thotë:<sup>70</sup> “Të dhënat e deklarimit të pasurisë së zyrtarit të lartë publik përfshijnë: emrin, mbiemrin, pozitën, emri i institucionit, adresa e institucionit, data e emërimit në funksion, data e dorëzimit të formularit, funksionet apo aktivitetet tjera që i ushtron zyrtari krahas funksionit publik, pasurinë e paluajtshme dhe llojin e saj, sipërfaqen, prejardhjen, vlerën e saj të paragjykuar dhe në pronësi të kujt është, pasurinë e luajtshme dhe llojin e saj, prejardhjen, viti i përfitimit, vlerën e saj të paragjykuar, dhe në pronësi të kujt është, aksionet në shoqëritë tregtare apo në ndonjë institucion tjetër, posedimi i letrave me vlerë, para të gatshme, detyrimet financiare që i ka zyrtari ndaj personave fizik dhe juridik dhe të hyrat vjetore, të gjitha këto duhet të publikohen në faqen e internetit të Agjencisë brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e kalimit të afatit për deklarim të pasurisë nga zyrtarët e lartë publik”. Përveç kësaj, shkelja akoma më e rëndë është ajo që ka të bëjë me referencën të cilën Pacolli e specifikon me rastin e deklarimit, sipas së cilës, kompanitë anonime të tij iu nënshtrohen ligjeve në fuqi të vendeve ku ato veprojnë, duke anashkaluar kështu rrjedhën logjike të zbatimit të barabartë të ligjit në Kosovë dhe mbase edhe vetë Kushtetutës së Republikës së Kosovës (Neni 3: Barazia para ligjit).

Më tutje, për të dëshmuar pamundësinë e AKK-së për verifikimin e origjinës së pasurisë do të hamendësojmë sikur Pacolli do të ishte përzgjedhur nga selektimi i rëndomtë për kontroll të plotë brenda 20 % të regjistrave që AKK kontrollon çdo vit sipas ligjit. Në një situatë të tillë, AKK-ja për asnjë çast nuk do të mund të verifikonte pasurinë e Pacollit sipas formatit të deklaruar dhe nuk do të mund të vinte në përfundim nëse rritja e kësaj pasurie ndër vite nga 80 milionë EUR në vitin 2011, në 125 milionë EUR në vitin 2013, që në total paraqet një rritje prej 45 milionë EUR, si rezultat i cilit aktivitet ka ardhur.

Marrë në përgjithësi, në rastin e Pacollit lindin argumente të rëndësishme që lidhen me problemin e verifikimit të origjinës së pasurisë së zyrtarëve të lartë publik si dhe disa shkelje ligjore që janë të rëndësishme për shqyrtim, të cilat ne i kemi vendosur si në vijim:

- 1) Përmes këtij rasti argumentohet pamundësia e AKK-së për të **verifikuar origjinën e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik jashtë vendit**, duke na e paraqitur kështu në vakum të plotë të kompetencave dhe metodologjisë së punës së AKK-së;
- 2) Meqenëse Pacolli kishte kërkuar që mos t’i publikohej pasuria, për vitin 2009, duke përjashtuar kështu barazinë para ligjit, si dhe me rastin e deklarimit të pasurisë sipas formatit që u shtrua më lart, mund të kuptojmë se në këtë rast janë bërë shkelje ligjore, përkatësisht është shkelur Ligji për Deklarimin e Pasurisë, dhe në mënyrë analogjike edhe neni 3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i cili përcakton barazinë para ligjit

<sup>70</sup> Ligji për Deklarimin e Pasurisë...Neni 13, paragrafi 1;

për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Për më tepër, paralelisht me veprimin e zyrtarit, edhe nga ana e AKK-së vërehet pasiviteti për të zbatuar dispozitat ligjore pasi që kjo formë e deklarimit të pasurisë nga Pacolli nuk është konsideruar se paraqet një shkelje nga ana e AKK-së;

- 3) Po ashtu nga ky rast kuptojmë se AKK-ja nuk ka instrumente për të matur vlefshmërinë e të dhënave të deklaruara të pasurisë sepse nuk ka qasje në pasurinë jashtë vendit dhe si e tillë, vlerat e deklaruara dhe veçanërisht rritja e pasurisë së subjektit në fjalë për 45 milionë, nuk dihet nëse paraqet një rritje reale apo thjeshtë një konstatim të hamendësuar nga ana e deklaruesit.

Ky rast dëshmon më së miri se në aspektin e verifikimit të vlefshmërisë së të dhënave, AKK-ja ka mangësi të mëdha të cilat do të duhej të rishikoheshin në tërësi në mënyrë që të presim një funksionim të mirëfilltë të sistemit të DP-së

### 9.2 Qasja “ortodokse” e verifikimit: Rasti i Agim Bahtirit

Një shembull tjetër si rast studimi që lidhet me pamundësinë e AKK-së për të verifikuar saktësinë e të dhënave dhe për të kuptuar përmbajtjen e tyre nga aspekti cilësor na paraqet edhe rasti i kryetarit të Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri.

Rasti i Bahtirit ishte iniciuar nga AKK-ja për të konstatuar nëse ka pasur konflikt interesi në të cilin përfshiheshin Bahtiri dhe partneri i tij i biznesit Hee Joo Park, të cilët janë bashkë aksionar në kompaninë “Green Mushroom Farm Kosova Sh.p.k”.<sup>71</sup> Në cilësinë e kryetarit të komunës, Bahtiri kishte propozuar Kuvendit Komunal të Mitrovicës, dhënien në shfrytëzim të një prone komunale për kompaninë “Mushroom Park L.L.C” pronar i së cilës është Hee Joo Park. Në këtë rast, AKK-ja kishte konstatuar si në vijim:<sup>72</sup>

**“Rasti mbyllet për shkak se nuk ka konflikt interesi në mes të kryetarit të komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri dhe kompanisë “Mushroom Park LLC”, për shkak se vendimi për dhënien e pronës është marrë nga Kuvendi Komunal”**

Argumentet e dhëna më tutje për marrjen e këtij vendimi nga ana e AKK-së aludonin në këto parametra:

- Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, kryetari nuk ka shkelur dispozitat për shkak se ai nuk e kishte rolin vendim-marrës për dhënien e pronës për shfrytëzim;

<sup>71</sup> Agjencioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë: “Green Mushroom Farm Kosova Sh.p.k”.

<http://www.arbk.org/sq/Rezultatet-e-Bizneseve/70562316?nb=0&eb=GREEN%20MUSHROOM%20FARM-KOSOVA>

<sup>72</sup> AKK, Vendime për Konflikte të Interesit: <http://ACA-ks.org/repository/docs/vendim-mbyllje%20k.i-%20Agim%20Bahtiri.pdf>

- Bazuar në Ligjin për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës, së paluajtshme të komunës (neni 5), është Kuvendi Komunal ai që ruan të drejtën për dhënien në shfrytëzim të pronave për personat fizik dhe juridik. Kryetari mund t'i propozojë kuvendit dhënien e pronës në fjalë (neni 6); *(Vërejtje nga Çohu!: Vendimi i marrë nga ana e Agjencisë edhe në aspektin teknik është i pasaktë sepse i është referuar Ligjit L/03-226 i vitit 2010,<sup>73</sup> i cili është shfuqizuar me rastin e nxjerrjes së ligjit të ri për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së komunës nr.04/L-144<sup>74</sup>)*

Duke ndjekur dispozitat ligjore të dhëna më lartë, AKK-ja ka arritur në përfundim se **“kryetari në këtë rast nuk është person vendim-marrës”**. Në këtë rast, nga perspektiva e verifikimit të konfliktit të interesit, AKK-ja nuk ka marrë në konsideratë disa segmente të rëndësishme si për shembull, faktin se Bahtiri dhe Park përveç se janë partner biznesi në kompaninë “Green Mushroom Farm Kosova Sh.p.k.”<sup>75</sup> e themeluar vetëm katër vite para marrjes së detyrës së kryetarit nga ana e Bahtirit, ka partneritet edhe me kompaninë tjetër të Bahtirit, “Green Mushroom Farm” me bazë në Holandë.<sup>76</sup> Në anën tjetër, Lee Park i cili ka marrë pronën komunale në shfrytëzim, e ka themeluar kompaninë “Mushroom Park L.L.C” me 22 maj 2014,<sup>77</sup> si një entitet i ri, natyrisht duke ditur faktin se kërkesa për shfrytëzimin e pronës në emër të kompanisë të përbashkët me Bahtirin do të mund të ishte interpretuar si konflikt interesi.

Në këtë kuptim, mund të konkludohet se AKK-ja në interpretimin e këtij vendimi nuk ka shkuar më tutje sesa interpretimi tekstual i normave ligjore, gjë që dëshmon pamundësinë e saj për të siguruar të dhëna për lidhjet e mundshme të subjekteve në fjalë dhe veçanërisht kur ato kanë lidhje të ngushta biznesi jashtë Kosovës. Këtu duket qartë se AKK-ja as që ka bërë ndonjë përpjekje duke qenë se është mjaftuar me konstatimin se Bahtiri nuk kishte rol vendim-marrës edhe pse kjo është diskutabile kur kemi parasysh faktin se ka qenë pikërisht në dorën e tij propozimi për dhënien në shfrytëzim të pronës për kompaninë me pronarin e së cilës ka interesa të ndërlidhura biznesi.

Me fjalë të tjera, AKK-ja nuk mund të verifikojë nëse kapitali i kompanisë përfituese të shfrytëzimit të pronës “Mushroom Park L.L.C” derivon nga të hyrat dhe nga kapitali i kompanisë tjetër të pronarit të njëjtë “Green Mushroom Farm Kosova SH.P.K” në të cilën është bashkëaksionarë edhe Bahtiri. Poashtu, hipotetikisht mund të thuhet se Hee Park, në të

<sup>73</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës: <http://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2729>

<sup>74</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës: <http://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2858>

<sup>75</sup> Shih regjistrin e biznesit ku kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri është në bashkpronësi me Lee Park, në kompaninë, Green Mushroom Farm Kosova SH.P.K”. <http://www.arbk.org/sq/Rezultatet-e-Bizneseve/70562316?nb=0&eb=GREEN%20MUSHROOM%20FARM-KOSOVA>

<sup>76</sup> Gazeta JnK; “Agim Bahtiri - Përgatitja e Terrenit për Biznes”; Njomza Salihi dhe Behar Mustafa; Gusht, 2014. <http://www.gazetajnk.com/?cid=1,987,8779>

<sup>77</sup> Agjencioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë: [http://www.arbk.org/sq/Rezultatet-e-Bizneseve/71062090?nb=0&eb=mushroom&la=0&lp=0&main\\_acitivity=0&other\\_acitivity=0&page\\_b=0](http://www.arbk.org/sq/Rezultatet-e-Bizneseve/71062090?nb=0&eb=mushroom&la=0&lp=0&main_acitivity=0&other_acitivity=0&page_b=0)

ardhmen mund të përdorë kapitalin e firmës së regjistruar në Kosovë si investim në zgjerimin e kapaciteteve të biznesit të kompanisë tjetër në të cilën është bashkëaksionarë edhe Bahtiri, që nënkupton se në mënyrë indirekte Bahtiri do të mund të ishte përfitues i të hyrave nga kompania që ka marrë në shfrytëzim pronën komunale, duke paraqitur kështu një konflikt të hapur të interesit të cilin AKK-ja nuk e ka marrë në konsideratë për shkak të paaftësisë së saj për të verifikuar lidhjet dhe interesat e subjekteve që i trajton.

Ky rast dhe shembujt e ofruar më lartë që flasin për pamundësinë e verifikimit të saktësisë së të dhënave mbi pasuritë e zyrtarëve të lartë publik nga ana e AKK-së, sipas pikëpamjes sonë nuk duhet adresuar vetëm në paaftësinë profesionale të saj dhe mungesës së vullnetit për punë, por mbi të gjitha, duhet adresuar në mandatin e saj që shpesh herë e vë në lajthitje si pasojë e dispozitave ligjore.



## 10. Përfundim

---

Nga shtjellimi i mësipërm i argumenteve rreth procesit të deklarimit të pasurisë dhe aspekteve problematike të tij, mund të kuptojmë që ky proces është një mjet i rëndësishëm në luftimin e korrupsionit politik, por i njëjti ende nuk është duke u materializuar në shkallën në të cilën do të duhej të prodhonte rezultate efektive. Shkaqet e identifikuara për një numër të madh problemesh, flasin për katër natyra kryesore të defekteve që e shoqërojnë procesin e deklarimit të pasurisë në Kosovë:

- **Së pari**, janë problemet e natyrës teknike që paraqesin një gamë të gjërë defektesh procedurale. Këto defekte lidhen me veprimtarinë e AKK-së, e cila ende nuk ka standardizuar disa aspekte të rëndësishme në formularët e deklarimit të pasurisë. Një devijim nga standardet e plotësimit të formularëve që një zyrtar mund ta bëjë me ose pa vetëdije është p.sh. mosparaqitja e vitit të përfitimit të një asemi, mungesa e vendosjes së titullarit të pronësisë, apo edhe mos reflektimi i zbritjes së shumës së kredisë. Këto defekte pastaj përbëjnë shkelje potenciale të Ligjit për Deklarim të Pasurisë, por një pjesë e madhe e tyre nuk janë trajtuar si të tilla nga AKK-ja.

Një pjesë e këtyre anomalive si p.sh. në rastin e deputetëve Hasani dhe Balje, do të mund të evitoheshin me një qasje më proaktive të AKK-së drejt zgjidhjes së rasteve përmes ofrimit të mundësisë së bashkëpunimit me palët përderisa një vullnet i tillë të ekzistojë, në mënyrë që misioni i parandalimit të korrupsionit dhe konfliktit të interesit të mos orientohet drejt formës por përmbajtjes. Natyrisht, se një standardizim i formave të deklarimit të pasurisë dhe standardizim i nocioneve përkatëse të entiteteve që janë të parapara për t'u deklaruar është më se i nevojshëm, në mënyrë që defektet teknike apo procedurale të evitohen me kohë;

- **Së dyti**, janë problemet e natyrës përmbajtësore, që paraqesin një mori defektesh në mënyrën e konstatimit të veprës penale për mosdeklarim apo deklarim të rrejshëm të pasurisë. Këto defekte lidhen në radhë të parë me metodologjinë e punës së AKK-së dhe me formën se si ajo i konstaton shkeljet përkatëse. Siç janë shpjeguar në këtë analizë, konstatimi i veprës penale për mosdeklarim apo deklarim të rremë të pasurisë jo gjithmonë ka qenë në anën e AKK-së. Ne kemi trajtuar dy raste, atë të deputetit Hasani dhe deputetës Balje, në të cilat konstatimi i AKK-së është konsideruar i pabazë. Në këtë drejtim, një mandat më i qartë dhe një metodologji e përcaktuar sakt me ligj është mëse e nevojshme në mënyrë që procesi i deklarimit të pasurisë të jetë i orientuar nga aspekti i rezultateve kuptimplota dhe jo të mjaftohet me aspektet strukturore të tij. Po ashtu,

kemi shtruar problematikën se mungesës së analizave aritmetike në mes të të hyrave të zyrtarëve të lartë publik dhe pasurive që ata/ato i posedojnë;

- **Së treti**, janë problemet e natyrës mandatuese, apo ato që lidhen me aspektet se deri ku shtrihet mandati i AKK-së për të realizuar në mënyrë të mirëfilltë procesin e deklarimit të pasurisë dhe për të siguruar transparencë të plotë. Në këtë rrafsh, kemi argumentuar më sipër për një mori problemesh siç janë mungesa e kompetencave të drejtëpërdrejta në qasjen në llogaritë bankare, apo në verifikimin e origjinës së pasurisë dhe në verifikimin e pasurisë jashtë vendit. Këto segmente janë të tilla që i japin kuptim të njëmendtë deklarimit të pasurisë, dhe përderisa AKK-ja nuk ka mandat për të operuar me to, procesi mbetet i mangët në mënyrë që të konstatohet vepra penale siç është paraparë me ligj;
- **Së katërti**, janë problemet e natyrës ligjore, që paraqesin aspektet e paqartësisë së zbatimit të vendimeve gjyqësore dhe dënimeve sipas KPRK-së për veprën e paraparë. Është argumentuar më lartë për kuptimet që marrin normat ligjore të parapara me nenin 437 të KPRK-së, moszbatimin e mirëfilltë të tyre dhe shkaqet e mundshme për këtë moszbatim adekuat. Siç kemi argumentuar, shqiptimi i dënimeve në të shumtën e rasteve nuk ka korresponduar me përshkrimin e dënimeve të parapara **“me gjobë dhe me burgim”**, por të njëjtat janë tjetërsuar dhe janë shqiptuar dënime alternative. Kjo natyrë e problemeve mbase derivon si pasojë e problemeve të tri kategorive të sipërpermendura, me ç'rast, është e nevojshme që procesi i deklarimit të pasurisë të mos pretendojë të asociojë drejtëpërdrejtë vetëm me dënimin dhe gjykatën, por që dënimi dhe gjykata të shihet si një agjens i pavarur që vepron mbi bazën e dëshmive të ofruara dhe që i shërben procesit të deklarimit të pasurisë në tërësi, si një shtyllë e jashtme.

Thënë në përgjithësi, Kosova ka një traditë relativisht të re të këtij procesi dhe duhet kohë që i njëjti të operacionalizohet në mënyrë të mirëfilltë aq sa të prodhojë rezultate konkrete. Megjithatë, mungesa e iniciativës për të shtyer përmirësimin e tij nuk mund të arsyetohet. Në të kundërtën, një proces që realizohet në mënyrë strukturore siç është duke ndodhur gjërë me tani, pa u fokusuar në aspektet përmbajtësore, do të prodhojë efektet e njëjta, të cilat sugjerojnë që korrupsioni po lulëzon dhe është i kudondodhur.

## 11. Rekomandimet Themelore

---

Në rrjedhën logjike të argumenteve të shtruar në këtë analizë politikash, në të cilën janë specifikuar disa fusha dhe aspekte problematike në procesin e deklarimit të pasurisë, rekomandimet e Çohu!-të lidhur me këtë fushë janë dhënë në vijim:

### **Rekomandimet lidhur me aspektin legjislativ:**

- 1) Të shqyrtohet legjislacioni aktual dhe të harmonizohen ligjet themelore kundër korrupsionit me ligjet tjera relevante dhe veçanërisht me Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës;
- 2) Të shqyrtohet dhe amandamentohet Ligji për Agjencinë Kundër Korrupsionit, në të cilin do të duhej të adresoheshin aspektet lidhur me mandatin e saj, posaçërisht rreth kontrollit të plotë të pasurisë dhe paralelisht me këtë mandat të specifikohen edhe shkalla e kompetencave dhe instrumentet përkatëse të nevojshme për realizimin e këtij kontrolli;
- 3) Shqyrtime të ligjore në të ardhmen duhet të përfshijnë dhe t'i kushtojnë një vëmendje të theksuar aspektit socio-politik dhe socio-kulturor në mënyrë që lufta kundër korrupsionit të reflektojë një pikëpamje më të zgjeruar të korrupsionit politik, përfshirë edhe pikat e mundshme ku ai është prezent, format e manifestimit dhe shtrirjen e tij horizontale dhe vertikale në institucione;

### **Rekomandimet lidhur me procesin e deklarimit të pasurisë:**

- 1) Të definohen instrumentet për verifikimin e origjinës së pasurisë, si një kategori ligjore dhe të sqarohet se deri në ç'masë ka mundësi AKK-ja që të verifikojë origjinën e pasurisë;
- 2) Të adresohet problemi i verifikimit të pasurisë jashtë vendit si një imperativ brenda mandatit të AKK-së dhe të specifikohen mekanizmat e nevojshëm për të realizuar këtë obligim;
- 3) Të adresohet problemi i qasjes në llogari bankare të zyrtarëve të lartë publik;
- 4) Agjencia Kundër Korrupsionit, duhet të fuqizohet me staf shtesë dhe të profesionalizuar posaçërisht në aspektin e hulumtimit dhe analizave aritmetike mbi relacionin e të hyrave dhe pasurive të poseduara nga zyrtarët e lartë publik;
- 5) Të standardizohen nocionet e vlerës së pasurisë së deklaruar bazuar në vlerën e tregut real, në mënyrë që të dhënat mbi pasurinë e patundshme siç janë pronat, të përcillen me vlera reale dhe jo sipas hamendjes së deklaruesve;
- 6) Të standardizohen emërtimet përmbajtësore të pronës dhe pasurisë së paluajtshme pasi që emërtimet e ndryshme shpeshherë paraqiten me vlera të njëjta materiale përderisa është i njohur fakti se disa forma të pronës për nga natyra kanë tjetër vlerë

materiale. Pra është e nevojshme që të përcaktohen qartë emërtimet mbi pronën e paluajtshme në mënyrë që AKK-ja ta ketë më të lehtë vlerësimin e vlerës së tyre;

- 7) Të kërkohej përgjegjësi më e shtuar nga Pikat e Kontaktit, pasi që për një numër të madh mosdeklaruesish me rastin e marrjes së detyrës, aludohet në mungesën e përcjelljes së informatave përkatëse nga këto pika;
- 8) T'i krijohet hapësirë e mirëfilltë shoqërisë civile që të ndërveprojë me AKK-në me qëllim të promovimit sa më të madh të luftës kundër korrupsionit;
- 9) Agjencia Kundër Korrupsionit, duhet që të ofrojë përshkrim shtesë mbi natyrën e rasteve që i heton dhe t'i shmanget kodifikimit të rasteve vetëm sipas neneve të KPRP-së. Kodifikimi i rasteve duke u bazuar vetëm sipas dispozitave të KPRK-së, nuk i lejon publikut të njihet me natyrën e korrupsionit në vend, duke qenë se nuk ofron përshkrim të detajuar mbi natyrën e veprës së shkaktuar.
- 10) Agjencia Kundër Korrupsionit, duhet të ketë një qasje më proaktive në evitimin e rasteve të 'deklarimit të rrejshëm' të pasurisë përmes kontaktimit të zyrtarëve dhe ofrimit të mundësisë për shpjegime dhe arsyetime të nevojshme, në mënyrë që t'i shërbejë procesit të deklarimit të pasurisë dhe të evitojë qasjen e deritanishme të procedimit të rasteve drejtpërdrejtë në gjyq, duke rritur numrin e lëndëve si indikator të punës së saj;
- 11) Regjistrat e pasurisë tek pjesa e kredisë duhet t'i përmbajnë katër elemente: **a)** data e marrjes së kredisë, **b)** data e përfundimit, **c)** shumën totale të kredisë së marrë, si dhe; **d)** shuma reale e borxhit (vlera e zbritur nga borxhi total e cila reflekton borxhin real ndaj një institucioni bankar apo financiar);
- 12) Agjencia Kundër Korrupsionit, duhet të ndërmarrë analiza përmbajtësore mbi shkaqet, llojet dhe natyrën e korrupsionit si dhe të identifikojë caqet e mundshme të tij;

### Rekomandimet lidhur me aspektin e trajtimit të veprave kundër korrupsionit

- 1) Të rritet trendi i shqyrtimit të lëndëve kundër korrupsionit nga ana e gjykatave, aq më tepër kur specifikat e veprave penale që lidhen me mosdeklarim apo deklarim të rrejshëm të pasurisë janë shumë të qarta dhe të precizuara në Kodin Penal, që mundësojnë një shqyrtim të lehtë;
- 2) Të shqiptohen dënimet përkatëse siç janë parashikuar me Kodin Penal, pra “me gjobë dhe me burgim” dhe të mos devijohet interpretimi i vendimeve me masa të tjera alternative pasi që Neni 437 i Kodit Penal, është shumë i qartë sa i përket masave të parapara ndëshkuese;
- 3) Të harmonizohen të dhënat statistikore në mes të rasteve të iniciuara nga AKK-ja, rasteve të trajtuara nga prokuroria dhe gjykatat, përkatësisht, të specifikohet natyra e rasteve, pra nëse bëhet fjalë për raste individësh apo raste veprash, si dhe nëse bëhet fjalë për llojin e veprës “mosdeklarim” apo “deklarim të rrejshëm”, pasi që pasqyrimi i

tillë mundëson një qasje më të lehtë në analizat e akterëve të tjerë të përfshirë në agjendën kundër korrupsionit.